FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 180

Tiranë – E martë, 13 tetor 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 60/2020, datë 7.10.2020	Për emërimin e zonjës Mimoza Kaçi në detyrën e anëtarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që do të mbajë funksionin e nëndrejtorit ekzekutiv të këtij institucioni	12513
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 785, datë 7.10.2020	Për miratimin e memorandumit të bashkëpunimit ekonomik, për projektet dhe blerjet në Shqipëri, ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës	12513
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 792, datë 7.10.2020	Për përcaktimin e kushteve dhe të kritereve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale	12516
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 793, datë 7.10.2020	Për përcaktimin e kushteve të posaçme e të kritereve të licencimit, dokumenteve shoqëruese dhe procedurave për shqyrtimin ose revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore	12534
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 24, datë 8.10.2020	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 13, datë 22.5.2019, "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit 'Mësues për Shqipërinë'", të ndryshuar	12543
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut nr. 1175/06, datë 23.6.2020	Çështja Kasmi kundër Shqipërisë	12544
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut nr. 40554/04, datë 26.5.2020	Çështja Robert Vevecka kundër Shqipërisë	12558

Vendim *(i shkurtuar)* për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Gjenci Lena..... 12565

Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Arben Allko..... 12565

Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Lulëzim Lila..... 12565

VENDIM
Nr. 60/2020

PËR EMËRIMIN E ZONJËS MIMOZA KAÇI NË DETYRËN E ANËTARIT TË BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE, QË DO TË MBAJË FUNKSIONIN E NËNDREJTORIT EKZEKUTIV TË KËTIJ INSTITUCIONI

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 5 dhe 6, të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", të ndryshuar, si dhe të nenit 111, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Emërimin e zonjës Mimoza Kaçi në detyrën e anëtarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që do të mbajë funksionin e Nëndrejtorit Ekzekutiv të këtij institucioni me një mandat 5-vjeçar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 7.10.2020

VENDIM
Nr. 785, datë 7.10.2020

PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT EKONOMIK, PËR PROJEKTET DHE BLERJET NË SHQIPËRI, NDËRMJET SHQIPËRISË DHE SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të bashkëpunimit ekonomik, për projektet dhe blerjet në Shqipëri, ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI EKONOMIK
PËR PROJEKTET DHE BLERJET NË SHQIPËRI NDËRMJET SHQIPËRISË DHE SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

Shqipëria, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Shtetet e Bashkuara) përfaqësuar nga Departamenti i Shtetit të SHBA-së, në vijim bashkërisht të referuar si "Pjesëmarrës" dhe individualisht të referuar si "Pjesëmarrës", "Shqipëria" ose "Shtetet e Bashkuara":

duke konfirmuar se Pjesëmarrësit kanë marrëdhënie miqësore dhe produktive dhe kërkojnë përmirësimin e bashkëpunimit dypalësh në disa sektorë ekonomikë, në frymën e Deklaratës së Përbashkët të Partneritetit Strategjik;

duke theksuar se Pjesëmarrësit kërkojnë forcimin e mëtejshëm të lidhjeve ekzistuese ndërmjet dy vendeve të tyre dhe, në veçanti, kërkojnë nxitjen e pjesëmarrjes tregtare, eksportin e mallrave dhe shërbimeve dhe investimet nga sektori privat i Shteteve të Bashkuara në projekte dhe blerje të menaxhuara nën kujdesin e Shqipërisë;

duke theksuar më tej se Pjesëmarrësit synojnë që përmes këtij Memorandumi të Bashkëpunimit Ekonomik (në vijim i referuar si "MBE") të përmirësojnë bashkëpunimin e tyre ekonomik;

duke pasur parasysh Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit dhe Nismat e zbatueshme Rajonale Antikorrupsion;

duke pasur, gjithashtu, parasysh se reformat e orientuara drejt tregut dhe një kuadër i qëndrueshëm investimesh me stimuj të duhur taksash dhe mbrojtje të fuqishme të investitorëve janë të dobishëm për tërheqjen dhe mbështetjen e investimeve të huaja;

duke ritheksuar qëllimin e tyre për të nxitur në Shqipëri një kuadër investimesh të hapur dhe jodiskriminues, paraqet kushte të barabarta, mbron investitorët dhe investimet, përfshin zgjidhjen e drejtë dhe të detyrueshme të mosmarrëveshjeve, ndjek rregullat e transparencës së qëndrueshme dhe pjesëmarrjes publike, promovon sjelljen e përgjegjshme të biznesit dhe bazon çdo rishikim të investimeve të huaja në rreziqe të mirëfillta të sigurisë kombëtare;

duke konfirmuar mbështetjen e tyre për tender dhe procese të prokurimit të hapura dhe të përgjegjshme;

duke konfirmuar hapjen e Shteteve të Bashkuara për ndarjen dhe qëllimin e Shqipërisë për të përfshirë praktikat më të mira, në lidhje me prokurimin që integrojnë studimet e fizibilitetit të Pjesëmarrësve të tretë, përgatitjen e projektit që mund të përfshijë vendosjen e standardeve të reja, ku nuk mund të zbatohen standarde të zbatueshme ndërkombëtare dhe vlerësimin e ofertave dhe procedurave të përzgjedhjes që përfshijnë analizën e kostos së ciklit jetësor për të përcaktuar vlerën më të mirë;

duke ritheksuar synimin e tyre se projektet dhe blerjet që do të kryhen në një mënyrë plotësisht, në përputhje me të drejtën e brendshme dhe ndërkombëtare, si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të synuara për parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit;

duke ritheksuar, gjithashtu, rëndësinë e ruajtjes së standardeve të larta të lidhura me shëndetin, sigurinë, mjedisin, punën, transparencën dhe qeverisjen e mirë për projektet dhe blerjet; dhe

duke vepruar në bazë të barazisë dhe përfitimit të ndërsjellë,

kanë arritur mirëkuptimet e mëposhtme:

I. Bashkëpunimi ekonomik

A. Pjesëmarrësit kanë interes të ndërsjellë në forcimin e lidhjeve tregtare dhe nxitjen e pjesëmarrjes tregtare nga shoqëritë amerikane në projektet dhe blerjet e menaxhuara nën kujdesin e Shqipërisë, me synim promovimin e prosperitetit, sigurisë dhe lidhjeve rajonale.

B. Pjesëmarrësit synojnë të inkurajojnë bizneset të kryejnë veprime në Shqipëri, në mënyrë të përgjegjshme dhe të harmonizojnë praktikat me udhëzimet e OECD-së për ndërmarrjet shumëkombëshe.

C. Në njohje të objektivave plotësues të Pjesëmarrësve, në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e projekteve dhe blerjeve në Shqipëri, Shqipëria synon të ofrojë informacion (siç është një listë e projekteve qeveritare të prokurimit), që mund të ndahet gjerësisht nga Pjesëmarrësit me shoqëritë që mund të kenë interes për të marrë pjesë në këto projekte.

D. Sektorët e projekteve të synuara për bashkëpunim, në kuadër të MBE-së, mund të përfshijnë, por nuk kufizohen tek:

1. Eksplorimi dhe zhvillimi i energjisë;
2. Infrastruktura (e përcaktuar nga Banka Botërore, si: projekte në sektorët e energjisë, transportit, ujit, teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit dhe mbetjeve të ngurta bashkiake);
3. Turizmi;
4. Teknologjia;
5. Bujqësia.

E. Shqipëria synon të përfshijë praktikat më të mira të ndara nga Shtetet e Bashkuara për të siguruar që blerjet e menaxhuara nën kujdesin e Shqipërisë të jenë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare, duke përfshirë studimet e fizibilitetit të Pjesëmarrësve të tretë dhe procedurat e vlerësimit dhe përzgjedhjes së ofertave që përfshijnë analizën e kostos së ciklit të jetës për të përcaktuar vlerën më të mirë.

F. Shtetet e Bashkuara synojnë të ndërmarrin hapat e duhur dhe të sigurojnë shoqëritë amerikane me informacion, në lidhje me financimin e mundshëm, duke përfshirë kreditë e eksportit, grantet dhe burimet e tjera qeveritare amerikane në dispozicion të aplikantëve të kualifikuar, siç është sigurimi i mbrojtjes tregtare, për të lehtësuar pjesëmarrjen e shoqërive amerikane në projekte dhe blerje, duke përfshirë ato të financuara nga institucione financiare ndërkombëtare ose burime të sektorit privat.

G. Shtetet e Bashkuara konfirmojnë interesin e tyre për të promovuar pjesëmarrjen e shoqërive amerikane në projekte dhe blerje në Shqipëri dhe konfirmojnë qëllimin e tyre për t'u angazhuar përmes përdorimit të "ekipeve të marrëveshjes" të përbërë nga agjenci dhe programe amerikane, duke përfshirë, por pa u kufizuar tek anëtarët e ekipit qendror të marrëveshjes DC: Departamentin e Shtetit të SHBA-së, Departamentin e Tregtisë të SHBA-së (i cili përfshin Shërbimin e Jashtëm Tregtar të Shteteve të Bashkuara), Departamentin e

Mbrojtjes të SHBA-së, Departamentin e Energjisë të SHBA-së, Departamentin e Transportit të SHBA-së, Departamentin e Thesarit të SHBA-së, Agjencinë për Zhvillimin Ndërkombëtar të SHBA-së, Korporatën Financiare të Zhvillimit të SHBA-së, Agjencinë e Tregtisë dhe Zhvillimit të SHBA-së (USTDA), Korporatën e Sfidës së Mijëvjeçarit dhe Bankën e Eksport-Importit të Shteteve të Bashkuara.

H. Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara synojnë të promovojnë partneritete midis dhe në përfitimin reciprok të shoqërive amerikane dhe aktorëve lokalë të interesit në Shqipëri, duke përfshirë por pa u kufizuar te zhvillimi i fuqisë punëtore lokale, fuqizimi ekonomik i femrave dhe mundësitë për inovacion.

I. Shqipëria përmes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Shtetet e Bashkuara, përmes Zyrës së Çështjeve Ekonomike dhe të Biznesit në Departamentin e Shtetit të SHBA-së synojnë të koordinohen me Ambasadën e Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara dhe Ambasadën e SHBA-së në Shqipëri për promovimin e mundësive të biznesit përmes përdorimit të programit *webinar DirectLine*. *Webinar*-ët *DirectLine* mund të përdoren për të prodhuar lista të firmave amerikane që kanë interes në sektorët specifikë ose në projekte ose blerje.

J. Shtetet e Bashkuara, përmes Zyrës së Çështjeve Ekonomike dhe të Biznesit në Departamentin e Shtetit të SHBA-së, synojnë të punojnë me agjencitë e tjera përkatëse të SHBA-së për të zhvilluar mundësi për ndihmë teknike në Shqipëri që përqendrohen në praktikat më të mira dhe standardet e njohura ndërkombëtare në menaxhimin e prokurimeve dhe të projekteve qeveritare.

K. Shqipëria përmes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Shtetet e Bashkuara, përmes Zyrës së Çështjeve Ekonomike dhe të Biznesit në Departamentin e Shtetit të SHBA-së synojnë të koordinohen me Ambasadën e Shqipërisë në SHBA dhe Ambasadën e SHBA-së në Shqipëri për përdorimin e burimeve të disponueshme të financimit, të tilla si: Fondi Nxitës i Lehtësimit të Biznesit të Departamentit të Shtetit ose Sigurimi i Mundësive për Fondin e Zhvillimit Ekonomik të Grave, për programet e promovimit tregtar dhe komercial në Shqipëri.

L. Pjesëmarrësit synojnë të shqyrtojnë bashkërisht përdorimin e mjeteve të tjera të qeverisë së SHBA-së, që mund të nxisin rritjen ekonomike në Shqipëri. Për shembull: Financimin e eksportit EXIM, financimin DFC, studimet e fizibilitetit USTDA dhe trajnime të tjera të përshtatshme të qeverisë së Shteteve të Bashkuara, opsionet e financimit dhe asistencën teknike.

M. Pjesëmarrësit synojnë të lehtësojnë bashkëpunimin midis shoqatave të biznesit dhe dhomave të tregtisë përkatëse për të promovuar dhe zhvilluar aktivitete ekonomike të përbashkëta, si shkëmbimi i informacionit dhe eksperiencave, si dhe organizimin e forumeve të biznesit, panaireve të tregtisë, trajnimeve dhe konferencave.

II. Kushtet e përgjithshme

A. Pjesëmarrësit synojnë të krijojnë një grup pune konsultimi dhe të identifikojnë pikat e kontaktit brenda një muaji nga nënshkrimi i kësaj MBE-je për t'u takuar në çdo moment që vendoset bashkërisht dhe paraprakisht nga Pjesëmarrësit për të diskutuar:

i. mënyrën e zbatimit të kësaj MBE-je;

ii. propozimet për rritjen e bashkëpunimit ekonomik;

iii. pengesat që pengojnë bashkëpunimin ekonomik dypalësh dhe, sipas rastit, rekomandojnë zgjidhje;

iv. çdo çështje tjetër që rrjedh nga kjo MBE.

B. Secili Pjesëmarrës mund të ndërpresë bashkëpunimin e tij, sipas kësaj MBE-je në çdo kohë. Një Pjesëmarrës, që dëshiron të ndërpresë bashkëpunimin e tij sipas kësaj MBE-je, duhet të bëjë përpjekje t'i japë Pjesëmarrësit tjetër një njoftim paraprak me shkrim të paktën gjashtë muaj përpara, mbi qëllimin e tij për këtë ndërprerje.

C. Kjo MBE nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e palëve të treta ose të drejtat e Pjesëmarrësve për të lidhur marrëveshje, kontrata, protokolle ose angazhime të tjera në lidhje me çdo çështje të përshkruar në këtë MBE.

D. Pjesëmarrësit do të mbulojnë kostot dhe shpenzimet e tyre të cilat lindin gjatë zbatimit të kësaj MBE-je. Aktivitetet e zhvilluara nga Pjesëmarrësit, në lidhje me këtë MBE, varen nga disponueshmëria e fondeve dhe burimeve të tjera, dhe u nënshtrohen ligjeve dhe rregulloreve të vendeve të tyre përkatëse.

E. Kjo MBE nuk është ligjërisht e detyrueshme dhe nuk ka për qëllim të krijojë ndonjë të drejtë ose detyrim sipas ligjit të brendshëm ose ndërkombëtar.

F. Pjesëmarrësit synojnë të adresojnë çdo ndryshim mendimi që lind midis tyre, në lidhje me interpretimin e kësaj MBE-je, vetëm përmes konsultimeve miqësore.

G. Çdo rishikim i përmbajtjes së kësaj MBE-je do të bëhet me shkrim sikundërse përcaktohet nga Pjesëmarrësit.

Nënshkruar në _____, sot _____ 2020, në dy origjinale në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze.

Për Shqipërinë
Znj. Anila Denaj
Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Z. Keith Krach
Zv. Sekretar i Shtetit për Rritjen Ekonomike, Energjinë dhe Mjedisin

VENDIM
Nr. 792, datë 7.10.2020

PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË KRITEREVE TË POSAÇME TË LICENCIMIT, DOKUMENTEVE SHOQËRUESE, NËNKATEGORIVE TË LICENCAVE, PROCEDURAVE PËR DHËNIEN, PEZULLIMIN OSE REVOKIMIN, SI DHE KUOTIZACIONIT VJETOR TË LICENCAVE PËR NDËRHYRJET NË PASURITË KULTURORE MATERIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 82, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky vendim përcakton dhe shtrin fushën e veprimit në

a) llojet, kategoritë dhe nënkategoritë e licencave për veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale;

b) përcaktimin e kushteve, kritereve të posaçme dhe dokumenteve shoqëruese për licencimin e individëve dhe licencimin e personave fizikë dhe juridikë, për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale;

c) procedurat për dhënien, pezullimin, revokimin dhe kuotizacionin e licencave për veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale.

II. LLOJET, KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË E LICENCAVE DHE KUSHTET PËR LICENCIM

1. Licenca për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale është akti administrativ që i njeh titullarit të saj të drejtën të fillojë e të ushtrojë tipin e veprimtarisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.

2. Llojet e licencave për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale janë në

a) projektim (P);

b) zbatim (Z);

c) mbikëqyrje dhe kolaudim (MK).

3. Kategoritë e licencave për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale janë si më poshtë vijon:

a) licencë për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, të arkitekturës/ndërtimore – (A);

b) licencë për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, vepra arti – (V).

4. Nënkategoritë e licencave për individin në projektim (P) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në kategoritë (A) dhe (V), janë si më poshtë vijon:

a) P/A/1. Projektim në konservim dhe restaurim i rrënojave/siteve arkeologjike;

b) P/A/2. Projektim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;

c) P/A/3. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;

ç) P/A/4. Projektim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;

d) P/A/5. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);

dh) P/A/6. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;

e) P/A/7. Projektim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;

ë) P/V/1. Projektim në konservim dhe restaurim i mozaikëve;

f) P/V/2. Projektim në konservim dhe restaurim i pikturave murale dhe shkëmbore;

g) P/V/3. Projektim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në dru;

gj) P/V/4. Projektim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në allçi, gur, qeramikë;

h) P/V/5. Projektim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në metal, qelq;

i) P/V/6. Projektim në konservim dhe restaurim të objekteve tekstil, lëkurë, pergamenë, telajo, letër.

5. Nënkategoritë e licencave për individin në zbatim (Z) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në kategoritë (A) dhe (V) janë si më poshtë vijon:

a) Z/A/1. Zbatim në konservim dhe restaurim i rrënojave/siteve arkeologjike;

b) Z/A/2. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;

c) Z/A/3. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;

ç) Z/A/4. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;

d) Z/A/5. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);

dh) Z/A/6. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;

e) Z/A/7. Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;

ë) Z/V/1. Zbatim në konservim dhe restaurim i mozaikëve;

f) Z/V/2. Zbatim në konservim dhe restaurim i pikturave murale dhe shkëmbore;

g) Z/V/3. Zbatim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në dru;

gj) Z/V/4. Zbatim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në allçi, gur, qeramikë;

h) Z/V/5. Zbatim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në metal, qelq;

i) Z/V/6. Zbatim në konservim dhe restaurim i objekteve tekstil, lëkurë, pergamenë, telajo, letër.

6. Nënkategoritë e licencave për individin në mbikëqyrje dhe kolaudim (MK) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në kategoritë (A) dhe (V), janë si më poshtë vijon:

a) MK/A/1. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i rrënojave/siteve arkeologjike;

b) MK/A/2. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;

c) MK/A/3. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;

ç) MK/A/4. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;

d) MK/A/5. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);

dh) MK/A/6. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;

e) MK/A/7. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;

ë) MK/V/1. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i mozaikëve;

f) MK/V/2. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i pikturave murale dhe shkëmbore;

g) MK/V/3. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në dru;

gj) MK/V/4. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në allçi, gur, qeramikë;

h) MK/V/5. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim të veprave të artit në metal, qelq;

i) MK/V/6. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i objekteve tekstil, lëkurë, pergamenë, telajo, letër.

7. Nënkategoritë e licencave për personin fizik (F-) në projektim (P) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në kategoritë (A) dhe (V), janë si më poshtë vijon:

a) F-P/A/1. Projektim në konservim dhe restaurim i rrënojave/siteve arkeologjike;

b) F-P/A/2. Projektim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;

c) F-P/A/3. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;

ç) F-P/A/4. Projektim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;

d) F-P/A/5. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);

dh) F-P/A/6. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;

e) F-P/A/7. Projektim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;

ë) F-P/V/1. Projektim në konservim dhe restaurim i mozaikëve;

f) F-P/V/2. Projektim në konservim dhe restaurim i pikturave murale dhe shkëmbore;

g) F-P/V/3. Projektim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në dru;

gj) F-P/V/4. Projektim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në allçi, gur, qeramikë;

h) F-P/V/5. Projektim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në metal, qelq;

i) F-P/V/6. Projektim në konservim dhe restaurim i objekteve tekstil, lëkurë, pergamenë, telajo, letër.

8. Nënkategoritë e licencave për personin fizik (F-) në zbatim (Z) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në kategoritë (A) dhe (V), janë:

a) F-Z/A/1. Zbatim në konservim dhe restaurim të rrënojave/siteve arkeologjike;

b) F-Z/A/2. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;

c) F-Z/A/3. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;

ç) F-Z/A/4. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;

d) F-Z/A/5. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);

dh) F-Z/A/6. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;

e) F-Z/A/7. Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;

ë) F-Z/V/1. Zbatim në konservim dhe restaurim i mozaikëve;

f) F-Z/V/2. Zbatim në konservim dhe restaurim i pikturave murale dhe shkëmbore;

g) F-Z/V/3. Zbatim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në dru;

gj) F-Z/V/4. Zbatim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në allçi, gur, qeramikë;

h) F-Z/V/5. Zbatim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në metal, qelq;

i) F-Z/V/6. Zbatim në konservim dhe restaurim i objekteve tekstil, lëkurë, pergamenë, telajo, letër.

9. Nënkategoritë e licencave për personin fizik (F-) në mbikëqyrje dhe kolaudim (MK) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në kategoritë (A) dhe (V), janë si më poshtë vijon:

a) F-MK/A/1. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i rrënojave/siteve arkeologjike;

b) F-MK/A/2. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;

c) F-MK/A/3. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;

ç) F-MK/A/4. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;

d) F-MK/A/5. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);

dh) F-MK/A/6. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;

e) F-MK/A/7. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;

ë) F-MK/V/1. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i mozaikëve;

f) F-MK/V/2. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i pikturave murale dhe shkëmbore;

g) F-MK/V/3. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në dru;

gj) F-MK/V/4. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në allçi, gur, qeramikë;

h) F-MK/V/5. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në metal, qelq;

i) F-MK/V/6. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i objekteve tekstil, lëkurë, pergamenë, telajo, letër.

10. Nënkategoritë e licencave për personin juridik (N-) në projektim (P) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në kategoritë (A) dhe (V) janë si më poshtë vijon:

a) N-P/A/1. Projektim në konservim dhe restaurim i rrënojave/siteve arkeologjike;

b) N-P/A/2. Projektim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;

c) N-P/A/3. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;

ç) N-P/A/4. Projektim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;

d) N-P/A/5. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);

dh) N-P/A/6. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;

e) N-P/A/7. Projektim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;

ë) N-P/V/1. Projektim në konservim dhe restaurim i mozaikëve;

f) N-P/V/2. Projektim në konservim dhe restaurim i pikturave murale dhe shkëmbore;

g) N-P/V/3. Projektim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në dru;

gj) N-P/V/4. Projektim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në allçi, gur, qeramikë;

h) N-P/V/5. Projektim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në metal, qelq;

i) N-P/V/6. Projektim në konservim dhe restaurim i objekteve tekstil, lëkurë, pergamenë, telajo, letër.

11. Nënkategoritë e licencave për personin juridik (N-) në zbatim (Z) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në kategoritë (A) dhe (V), janë si më poshtë vijon:

a) N-Z/A/1. Zbatim në konservim dhe restaurim të rrënojave/siteve arkeologjike;

b) N-Z/A/2. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;

c) N-Z/A/3. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;

ç) N-Z/A/4. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;

d) N-Z/A/5. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);

dh) N-Z/A/6. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;

e) N-Z/A/7. Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;

ë) N-Z/V/1. Zbatim në konservim dhe restaurim i mozaikëve;

f) N-Z/V/2. Zbatim në konservim dhe restaurim i pikturave murale dhe shkëmbore;

g) N-Z/V/3. Zbatim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në dru;

gj) N-Z/V/4. Zbatim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në allçi, gur, qeramikë;

h) N-Z/V/5. Zbatim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në metal, qelq;

i) N-Z/V/6. Zbatim në konservim dhe restaurim i objekteve tekstil, lëkurë, pergamenë, telajo, letër.

12. Nënkategoritë e licencave për personin juridik (N-) në mbikëqyrje dhe kolaudim (MK) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në kategoritë (A) dhe (V), janë si më poshtë vijon:

a) N-MK/A/1. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i rrënojave/siteve arkeologjike;

b) N-MK/A/2. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;

c) N-MK/A/3. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;

ç) N-MK/A/4. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;

d) N-MK/A/5. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);

dh) N-MK/A/6. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;

e) N-MK/A/7. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;

ë) N-MK/V/1. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i mozaikëve;

f) N-MK/V/2. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i pikturave murale dhe shkëmbore;

g) N-MK/V/3. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në dru;

gj) N-MK/V/4. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në allçi, gur, qeramikë;

h) N-MK/V/5. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i veprave të artit në metal, qelq;

i) N-MK/V/6. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i objekteve tekstil, lëkurë, pergamenë, telajo, letër.

A. Kushtet e përgjithshme për pajisjen me licencë

1. Çdo individ, i cili ka zotësinë e plotë juridike për të vepruar, si dhe çdo person fizik apo juridik i regjistruar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për veprimtaritë tregtare, ka të drejtë të paraqesë

kërkesë për pajisje me licencë në projektim, zbatim, mbikëqyrje e kolaudim.

2. Subjekti dorëzon kërkesën e plotë për pajisjen me licencë, bashkë me dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për përfitimin e licencës, pranë Sekretarisë Teknike të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim "KKTKM"), si dhe dokumentet shoqëruese të kërkuara në këtë vendim për të provuar përmbushjen e kritereve të posaçme.

B. Kriteret e posaçme për licencimin për individ

1. Për të përfituar licencë për projektim të nënkategorive sipas pikës 4, të kreut II, të këtij vendimi, individi duhet:

a) të ketë një nga nivelet e edukimit sipas aneksit 1;

b) të ketë eksperiencë pune në profesion sipas aneksit 1;

c) të plotësojë kriteret sipas aneksit 1, përkatësisht:

i. për eksperiencën në institucion të specializuar në kuptim të ligjit nr. 27/2018, të lidhura me nënkategorinë;

ii. për specializimet ose kurset profesionale (teorike) të lidhura me nënkategorinë;

iii. për autorësi ose bashkautorësi në hartim projektesh konservim-restaurim, të miratuara sipas legjislacionit shqiptar në fushën e trashëgimisë kulturore të lidhura me nënkategorinë.

2. Për të përfituar licencë për zbatim të nënkategorive sipas pikës 5, të kreut II, të këtij vendimi, individi duhet:

a) të ketë një nga nivelet e edukimit sipas aneksit 2;

b) të ketë eksperiencë pune në profesion sipas aneksit 2;

c) të plotësojë kriteret sipas aneksit 2, përkatësisht, për:

i. eksperiencën në institucion të specializuar në kuptim të ligjit nr. 27/2018, të lidhura me nënkategorinë;

ii. specializimet ose kurset profesionale (kampe zbatimi restaurimi) të lidhura me nënkategorinë;

iii. autorësi ose bashkautorësi në hartim projektesh konservim-restaurim, të miratuara sipas legjislacionit shqiptar të trashëgimisë kulturore të lidhura me nënkategorinë.

3. Për të përfituar licencë për mbikëqyrje dhe kolaudim të nënkategorive sipas pikës 6, të kreut II, të këtij vendimi, individi duhet:

a) të ketë një nga nivelet e edukimit sipas aneksit 3;

b) të ketë eksperiencë pune në profesion sipas aneksit 3;

c) të plotësojë kriteret sipas aneksit 3, përkatësisht, për:

i. eksperiencën në institucion të specializuar në kuptim të ligjit nr. 27/2018, të lidhura me nënkategorinë;

ii. specializimet ose kurset profesionale (kampe zbatimi restaurimi) të lidhura me nënkategorinë;

iii. autorësi ose bashkautorësi në hartim projektesh konservim-restaurim të miratuara sipas legjislacionit shqiptar të trashëgimisë kulturore të lidhura me nënkategorinë.

C. Kriteret e posaçme për licencim për personin fizik/juridik

1. Kriteret e posaçme për licencim për personin fizik (F-) për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale janë si më poshtë vijon:

a) Të ketë të punësuar si drejtues teknik individin e licencuar në fushën e veprimtarisë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, që plotëson kushtet e posaçme për kategorinë/ nënkategorinë e licencës, sipas kreut II të këtij vendimi. Kontrata e punësimit ndërmjet personit fizik dhe individit të licencuar nuk mund të jetë më pak se 1 (një) vit. Personi fizik licencohet për të njëjtën kategori/nënkategori të licencës për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale që disponon drejtuesi teknik;

b) Në rastin kur personi fizik zotëron licencë si individ në fushën e veprimtarisë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, nuk ka nevojë të punësojë një drejtues teknik, sipas parashikimit të shkronjës "a", të kësaj pike.

2. Kriteret e posaçme për licencim për personin juridik (N-), për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, janë si më poshtë vijon:

a) Të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë si person juridik në veprimtarinë kryesore projektim dhe/ose zbatim dhe/ose mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të ndërtimit dhe/ose restaurimin e veprave të artit;

b) Të ketë të punësuar si drejtues teknik individ të licencuar në fushën e veprimtarisë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, që plotëson kushtet e posaçme për kategorinë/nënkategorinë e licencës, sipas kreut II të këtij vendimi. Kontrata e punësimit

ndërmjet personit juridik dhe individit të licencuar nuk mund të jetë më pak se 1 (një) vit. Personi juridik licencohet për të njëjtën kategori/nënkategori të licencës për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale që disponon drejtuesi teknik.

Ç. Kufizime për dhënien dhe përdorimin e licencës

1. Licenca nuk lejohet të tjetërsohet apo të trashëgohet nga një subjekt (individ, person fizik, person juridik) tek tjetri.

2. Individët e licencuar në fushën e veprimtarisë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, të cilët punojnë si drejtues teknikë pranë një personi fizik ose juridik të licencuar për zbatim, nuk mund të përdorin licencë si individë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit në konservim e restaurim, gjatë kohës që janë të punësuar në këtë pozicion.

3. Kur ndodh ndryshimi faktik i të dhënave të përcaktuara në licencë, të cilat kanë të bëjnë me kriteret e licencimit, pavarësisht se mund të cenojë apo jo këto kritere, subjekti (individ, person fizik, person juridik) duhet të njoftojë menjëherë në formë zyrtare, Sekretarinë Teknike të KKTKM-së, pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (në vijim "IKTK").

4. Kur vlerësohet se dokumentet e dorëzuara nga subjekti (individ, person fizik, person juridik) provojnë përmbushjen përsëri të kritereve të licencimit, atëherë KKTKM-ja miraton ndryshimet dhe subjekti pajiset me licencën e ndryshuar. Përdorimi i licencës pezullohet për periudhën deri në miratimin e ndryshimeve dhe pajisjen me licencën e ndryshuar.

D. Afatet e vlefshmërisë së licencës

1. Licenca për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale është pa afat, për të gjitha subjektet e licencuara.

2. Subjekti, person fizik apo juridik, njofton në formë zyrtare në Sekretarinë Teknike të KKTKM-së, pranë IKTK-së:

a) menjëherë, kur kontrata e punësimit të drejtuesit teknik ndërpritet përpara afatit;

b) të paktën 45 (dyzet e pesë) ditë përpara mbarimit të kontratës së punësimit të drejtuesit teknik, nëse kjo kontratë do të ripërtërihet;

c) të paktën 45 (dyzet e pesë) ditë përpara mbarimit të kontratës së punësimit të drejtuesit teknik, nëse kjo kontratë nuk do të ripërtërihet.

III. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES PËR PAJISJEN ME LICENCË

A. Dokumente shoqëruese për pajisjen me licencë për individin

Kërkesa për pajisje me licencë për herë të parë për individin, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme të përcaktuara në këtë vendim, shoqërohet me:

a) kërkesën për pajisje me licencë, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

b) kopjen e dokumentit të identifikimit;

c) dokumentin që vërteton kohën/vitet e punës (librezën e punës apo dokumente të tjera që vërtetojnë kohën/vitet e punës);

ç) vetëdeklarimin mbi gjendjen e tij gjyqësore dhe penale;

d) dy fotografi me përmasa 3x4 cm;

dh) kopjen e diplomave që zotëron, certifikata kursi apo specializimi, të njësuara me origjinalin.

B. Dokumente shoqëruese për pajisjen me licencë për personin fizik

Kërkesa për pajisje me licencë për herë të parë për personin fizik, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme të përcaktuara në këtë vendim, shoqërohet me:

a) kërkesën për pajisje me licencë, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

b) certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;

c) kopjen e dokumentit të identifikimit të aplikuesit;

ç) dokumentin që vërteton kohën/vitet e punës (librezën e punës apo dokumente të tjera që vërtetojnë kohën/vitet e punës) për aplikuesin;

d) vetëdeklarimin mbi gjendjen gjyqësore dhe penale;

dh) dy fotografi me përmasa 3x4 cm;

e) kopjen e diplomave që zotëron, certifikata kursi apo specializimi, të njësuara me origjinalin.

ë) në rastin e punësimit të drejtuesit teknik, kontratën e lidhur ndërmjet personit fizik dhe drejtuesit teknik të licencuar në fushën e veprimtarisë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, të hartuar përpara noterit;

f) vetëdeklarimin nga drejtuesi teknik ose nga personi fizik (në rastin kur personi fizik zotëron licencë në fushën e veprimtarisë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale), për:

i. gjendjen gjyqësore dhe penale;

ii. gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në persona fizikë apo juridikë të tjerë;

iii. marrëdhënien e tij të punës me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura apo persona juridikë publikë të tjerë.

C. Dokumente shoqëruese për pajisje me licencë për personin juridik

Kërkesa për pajisje me licencë për herë të parë për personin juridik, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme të specifikuara në këtë vendimi, shoqërohet me:

a) kërkesën për pajisje me licencë, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

b) certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;

c) vetëdeklarimin mbi gjendjen gjyqësore dhe penale të anëtarëve të organit administrativ, aksionarit ose ortakut, të personit që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda personit juridik;

ç) kontratën e punësimit ndërmjet përfaqësuesit ligjor të personit juridik dhe drejtuesit teknik të licencuar në fushën e veprimtarisë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, të hartuar përpara noterit;

d) vetëdeklarimin nga drejtuesi teknik, për:

i. gjendjen gjyqësore dhe penale;

ii. gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në persona fizikë apo juridikë të tjerë;

iii. marrëdhënien e tij të punës me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura apo persona juridikë publikë të tjerë.

Ç. Dokumente shoqëruese në rast ndryshimi të licencës

1. Kërkesa për pajisje me shtesa në kategori ose nënkategori dhe për ndryshim të licencës shoqërohet me:

a) kërkesën për pajisje me shtesa në kategori ose nënkategori dhe ndryshim të licencës, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

b) dokumentacionin përkatës që provon përmbushjen e kritereve për kategorinë/ nënkategorinë e kërkuar ose për ndryshimet.

2. Në rastin kur ndryshimi që kërkohet ka lidhje me shtesa në kategori ose nënkategori, me qëllim pajisjen me licencë të re, subjekti duhet të dorëzojë licencën ekzistuese. Licenca ekzistuese shpallet e pavlefshme dhe lëshohet licencë e re me shtesat. Licenca e shpallur e pavlefshme shenjohet nga Sekretaria Teknike e KKTKM-së me prerje në anë dhe arkivohet në dosjen e subjektit.

3. Në rastin kur ndryshimi që kërkohet ka lidhje me ndërrimin e drejtuesit teknik, përfaqësuesve ligjorë, ndryshim të emrit apo të selisë, mbarimin e afatit të kontratës së punësimit apo ripërtëritjen e afatit të kontratës së punësimit, me qëllim pajisjen me licencë të re, subjekti duhet të dorëzojë licencën ekzistuese. Licenca ekzistuese shpallet e pavlefshme dhe lëshohet licencë e re. Licenca e shpallur e pavlefshme shenjohet nga Sekretaria Teknike e KKTKM-së me prerje në anë dhe arkivohet në dosjen e subjektit.

D. Dokumente shoqëruese për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses

1. Kërkesa për pajisjen me zëvendësim licence, në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses, shoqërohet me:

a) kërkesën për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

b) dy fotografi për dokument.

2. Në rastin kur kërkesa ka lidhje me zëvendësimin e licencës së dëmtuar, me qëllim pajisjen me licencë të re, subjekti duhet të dorëzojë të dëmtuarën.

3. Licenca e dëmtuar ose e humbur shpallet e pavlefshme dhe lëshohet e re me të dhënat e njëjta dhe me datë lëshimi të re.

IV. PROCEDURAT PËR DHËNIEN, PEZULLIMIN OSE REVOKIMIN E LICENCËS PËR VEPRIMTARI NDËRHY-RËSE NË PASURITË KULTURORE MATERIALE

A. Dorëzimi dhe pranimi i kërkesave

1. Kërkesa për licencë, si dhe dokumentet shoqëruese të saj dërgohen nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit për veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*.

2. Dokumentet për licencë, që ngarkohen në sistem, duhet të jenë

a) origjinale ose kopje të njësuara me origjinalin;

b) në gjuhën shqipe ose të përkthyera në gjuhën shqipe nga përkthyes zyrtar dhe të njësuara me origjinalin;

c) për rastet e dokumenteve të huaja, kopje të vërtetuara nga një autoritet publik i juridiksionit të huaj (zyrtar/noter). Është detyrim të vërtetohet ekzistenca e tyre si zyrtarë apo noterë, nëpërmjet

legalizimit apo apostilimit, sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

3. Pagesa e tarifës për përfitimin e licencës kryhet nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit për veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania* ose pranë çdo banke të nivelit të dytë, nëpërmjet formularit të faturës për arkëtim.

4. Paraqitja fizike e një apo disa dokumenteve pranë sportelit unik do të kryhet vetëm në këto raste:

a) Për dorëzimin e fotografive të individit që aplikon, të cilat dorëzohen fizikisht nga aplikuesi, deri në momentin e tërheqjes së formularit të licencës;

b) Për dorëzimin e licencës paraardhëse, në rastet e parashikuara në këtë vendim;

c) Kur kërkohet verifikim i dokumentit/ dokumenteve nga Sekretaria Teknike e KKTKM-së.

B. Shqyrtimi i kërkesave për licencim

1. Kërkesa për licencim ose revokim të licencës për shtesa në kategori/nënkategori dhe ndryshim të licencës, si dhe për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses administrohet nga Sporteli Unik dhe Sekretaria Teknike e KKTKM-së, pranë IKTK-së.

2. Procedura e administrimit të kërkesës dhe e shqyrtimit të saj deri në vendimmarrje, me miratim ose jo të kërkesës, realizohet sipas rregullave të funksionimit të KKTKM-së, përcaktuar në "Rregulloren për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të saj", miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

3. KKTKM-ja merr vendim mbi kërkesën sipas rastit, licencim ose revokim të licencës për shtesa në kategori/nënkategori dhe ndryshim të licencës, si dhe për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga regjistrimi i kërkesës.

4. Ndaj vendimit të KKTKM-së mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

5. Sekretaria Teknike bën shpërndarjen e licencave të interesuarve jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e urdhrit të ministrit, nëpërmjet shërbimit postar ose licencat tërhiqen nga vetë personi i licencuar apo nga persona të autorizuar me akt noterial për të kryer një veprim të tillë apo personat e autorizuar nga personi juridik. Kopja e autorizimit depozitohet në dosjen që arkivohet.

6. Licenca e miratuar për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale për shtesa në kategori/nënkategori dhe ndryshim të licencës, për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses, si dhe çdo vendim për pezullim ose revokim të licencës, regjistrohet në Regjistrin e Licencave për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, i cili administrohet nga IKTK-ja, si dhe në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

C. Kuotizacioni vjetor i licencave

1. Kuotizacioni vjetor i licencave është një pagesë periodike vjetore që paguhet nga subjekti i licencuar, në vlerën 200 (dyqind) lekë.

2. Përjashtohet nga pagesa e kuotizacionit vjetor subjekti, licenca e të cilit është pezulluar ose revokuar, si dhe subjekti që ndodhet në kushtet e pikës 5, ndarja D, e këtij kreu.

3. Të ardhurat e përftuara nga pika 1, ndarja C, e këtij kreu, shkojnë në llogari të Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale.

Ç. Detyrimi i formimit të vazhdueshëm

1. Individi i licencuar ka detyrimin të kryejë formimin e vazhduar ose të marrë kreditet në përputhje me pikat 6 dhe 7, të nenit 82, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë".

2. Brenda datës 31 janar të çdo viti, individi i licencuar raporton pranë Sekretarisë Teknike mbi plotësimin e krediteve për vitin ushtrimor paraardhës, sipas parashikimit të pikës 1, të ndarjes D, këtij kreu.

D. Revokimi dhe pezullimi i licencës

1. Licenca revokohet me vendim të KKTKM-së, në rastet e parashikuara në pikën 1, të nenit 84, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", si dhe në rastet e mëposhtme:

a) në rastet kur në procedurat e konkurrimit publik të realizuara nga institucionet publike për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore, dokumentet e paraqitura nga subjekti i licencuar janë të rreme apo të falsifikuara;

b) në rastin e likuidimit të personit fizik ose juridik;

c) kur individi mbajtës i licencës humbet jetën.

2. Në rastin e parashikuar në shkronjën "b", të pikës 1, të kësaj ndarjeje, subjekti duhet të paraqesë në Sekretarinë Teknike të KKTKM-së, pranë IKTK-së, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) njoftimin me shkrim nga përfaqësuesi ligjor për mbylljen e aktivitetit, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

b) dorëzimin e licencës për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale që disponon;

c) dokumentin vërtetues nga QKB-ja për çregjistrimin e subjektit nga Regjistri Tregtar.

3. Për çdo rast të konstatuar nga DRTK-të ose IKMTK-ja, IKTK-ja harton një raport vlerësimi të fakteve dhe ia kalon për shqyrtim KKTKM-së, që merr vendim për revokimin e licencës për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale.

4. Licenca për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale pezullohet me vendim të KKTKM-së:

a) me kërkesë të vetë subjektit,

b) kur titullari i licencës ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit ose ka ndonjë pengesë tjetër ligjore, me ushtrimin e funksioneve publike në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar, për periudhën kohore që ekziston shkaku që ka çuar në pezullim.

c) nëse në mënyrë të përsëritur paraqet projekte që janë në kundërshtim me ligjin dhe/ose aktet nënligjore.

5. Përpara marrjes së vendimit të pezullimit, KKTKM-ja, si rregull, urdhëron riplotësimin e kritereve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve, brenda një afati të arsyeshëm, deri në ripërmbushjen e kritereve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve.

6. Ndaj vendimit për pezullimin e licencës me kërkesë të institucioneve dhe vendimit për revokimin e saj mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Licencat për çdo individ, person fizik dhe person juridik, të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve ose nga KKTKM-ja përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të konsiderohen të vlefshme deri 6 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Brenda këtij afati, subjektet duhet të bëjnë rinovimin e licencave me formatin e ri të kategorive, si dhe në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim. Pas këtij afati, licencat e parinovuara janë të pavlefshme.

2. Të gjitha subjektet, të cilat kanë paraqitur kërkesat për licencë për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe nuk janë shqyrtuar nga KKTKM-ja përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, duhet të dorëzojnë dokumentacionin plotësues, për të provuar plotësimin e kushteve për licencim sipas këtij vendimi, brenda afatit 31.12.2020.

3. Të gjitha kërkesat për licenca për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe aktet formale në lidhje me to bëhen me pagesë, sipas tarifave të miratuara me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrit përgjegjës për financat.

4. Të gjitha kërkesat për licenca për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe dokumentacioni shoqërues do të dërgohen në formë fizike nëpërmjet shërbimit postar pranë Sportelit Unik/Sekretarisë Teknike të IKTK-së deri në kalimin e të gjithë procedurës në sistemin elektronik për aplikimin *online* në portalin *e-Albania*.

5. Ngarkohet KKTKM-ja për miratimin e formatit të licencave, të cilat konsiderohen dokumente me vlerë që i nënshtrohen prodhimit të posaçëm.

6. Vendimi nr. 58, datë 10.01.2018, i Këshillit Kombëtar të Restaurimit, si dhe çdo akt tjetër nënligjor që bie ndesh me këtë vendim, shfuqizohen.

7. Ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

KRITERET PËR MARRJEN E LICENCËS NË PROJEKTIM

Unë i/e nënshkruari/a _____, me cilësinë e administratorit të subjektit "_____", deklaroj se: - Të dhënat e deklaruara dhe dokumentet e dorëzuar janë të vërteta. - Drejtuesi teknik restaurator nuk punon në një shoqëri tjetër dhe nuk është në marrëdhënie pune me shtetin. - Subjekti njeh dhe pranon kriteret dhe detyrimet e licencimit.
Vetëdeklarim mbi përgjegjësinë për veprimtarinë që do të kryejë individi (drejtues teknik)
1. Unë i/e nënshkruari/a _____, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklarim i pavërtetë, deklaroj se: - Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë, në lidhje me profesionin ku kërkoj të licencohem; ose - Kam çështje gjyqësore të hapur në Gjykatën e Rrethit _____ (shoqëruar me motivin e çështjes) ose/dhe jam në ndjekje penale nga organi i Prokurorisë së Rrethit _____ (shoqëruar me motivin e ndjekjes). 2. Unë i/e nënshkruari/a _____, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklarim i pavërtetë, deklaroj se: - Nuk kam asnjë penalizim nga strukturat shtetërore të ngarkuara për inspektimin ndërtimor e urbanistik; ose - Kam penalizim nga struktura shtetërore qendrore ose vendore _____ (shoqëruar me motivin e penalizimit).
Vetëdeklarim mbi përgjegjësinë mbi veprimtarinë që do të kryejë subjekti
1. Unë i/e nënshkruari/a _____, me cilësinë e administratorit të subjektit "_____", në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklarim i pavërtetë, deklaroj se: - Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me profesionin ku kërkoj të licencohemi; ose - Kam çështje gjyqësore të hapur në Gjykatën e Rrethit _____ (shoqëruar me motivin e çështjes) ose/dhe jam në ndjekje penale nga organi i Prokurorisë së Rrethit _____ (shoqëruar me motivin e ndjekjes). 2. Unë i/e nënshkruari/a _____, me cilësinë e administratorit të subjektit "_____", në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklarim i pavërtetë, deklaroj se: - Nuk kam asnjë penalizim nga strukturat shtetërore të ngarkuara për inspektimin ndërtimor e urbanistik; ose - Kam penalizim nga struktura shtetërore qendrore ose vendore _____ (shoqëruar me motivin e penalizimit).
Autorizimi i mëposhtëm është vullnetar
Autorizoj institucionin të përpunojë të dhënat e mia personale (emër, mbiemër, numër telefoni ose *email*) të mbledhura më sipër, me qëllim zhvillimin e sondazheve të automatizuara për marrjen e opinionit tim, në lidhje me cilësinë e ofrimit të shërbimit.
7. DOKUMENTACIONI I NGARKUAR
1. Kontrata e punës ndërmjet subjektit (personi fizik apo personi juridik) dhe drejtuesit teknik të licencuar
2. Deklaratë e drejtuesit teknik restaurator
3. Mandatpagesa
4. Dokumente të tjera
8. DOKUMENTET / VERIFIKIMET / MIRATIMET QË SIGUROHEN NGA BASHKËVEPRIMI NDËRINSTITUCIONAL
1. Ekstrakt regjistrim biznesi nga QKB ose vendimin e regjistrimit në gjykatë
2. Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore, taksave deri në momentin e paraqitjes së kërkesës (nga bashkia dhe drejtoritë tatimore)
3. Fotokopje e licencës personale të restauratorit (drejtues teknik)
4. Verifikim / informacion për veprimtarinë restauruese të individëve nga DRTK-ja
5. Verifikim / informacion për veprimtarinë restauruese të subjektit nga DRTK *(jo për aplikim për herë të parë)*
9. BAZA LIGJORE E KËTIJ SHËRBIMI
1. Ligji nr. 27/2018, date 17.5.2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë"
2. VKM nr.___, datë __.__.2020, "Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionin vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale"
10. NJOFTIMI

Marrja e informacionit:		Postë		*Email*		*e-Albania*	Dorazi
Email (për njoftimin):							
Afati i njoftimit:	Jo më vonë se 10 ditë nga vendimi i KKTKM-së						

VENDIM
Nr. 793, datë 7.10.2020

PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE TË POSAÇME E TË KRITEREVE TË LICENCIMIT, DOKUMENTEVE SHOQËRUESE DHE PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN OSE REVOKIMIN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË ARKEOLOGJIKE DHE VEPRIMTARINË ARKEOLOGJIKE NËNUJORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 136, pika 4, 137, pika 1, dhe 157, pikat 5 dhe 6, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kushteve të posaçme të licencimit, kritereve, dokumenteve shoqëruese dhe procedurave për shqyrtimin ose revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Kreu III, i "Rregullores mbi kriteret e ushtrimit të profesionit të arkeologut, kriteret e gërmimit, dokumentimit dhe arkivimit të të dhënave dhe materialeve arkeologjike", miratuar me vendimin nr. 2, datë 30.1.2009, të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, të ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

KUSHTET E POSAÇME TË LICENCIMIT, KRITERET, DOKUMENTET SHOQËRUESE, SI DHE PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN OSE REVOKIMIN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË ARKEOLOGJIKE DHE VEPRIMTARINË ARKEOLOGJIKE NËNUJORE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe fusha e veprimit

Ky vendim përcakton dhe shtrin fushën e veprimit në:

a) llojet e licencave dhe kushtet e posaçme për licencim për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore për individin, personin fizik dhe personin juridik;

b) dokumentacionin për pajisjen me licencë;

c) procedurën për shqyrtimin për dhënien ose revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore.

KREU II
LLOJET, KATEGORITË E LICENCAVE DHE KUSHTET PËR LICENCIM

Neni 2
Llojet dhe kategoritë e licencave për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore

1. Licencë për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore është akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtën të fillojë e të ushtrojë tipin e veprimtarisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.

2. Llojet e licencave për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore janë:

a) licenca për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore për individin;

b) licenca për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore për personin fizik;

c) licenca për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore për personin juridik.

3. Licencat për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore për individin, personin fizik dhe juridik, jepen për këto kategori:

a) A. Për veprimtarinë arkeologjike:

i. A1. Vëzhgim arkeologjik *(Survey)*;

ii. A2. Sondazhe arkeologjike;

iii. A3. Gërmim arkeologjik.

b) B. Për veprimtarinë arkeologjike nënujore:

i. B1. Vëzhgim arkeologjik *(Survey)* nënujor;

ii. B2. Sondazh arkeologjik nënujor;

iii. B3. Gërmim arkeologjik nënujor.

Neni 3
Kushtet e posaçme për licencim për individin

1. Për të përfituar licencë me kategorinë A1 - Vëzhgim arkeologjik *(Survey)*, individi duhet:

a) të zotërojë diplomë të ciklit të dytë në arkeologji ose histori, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë apo të ketë diplomën ekuivalente, të njohur dhe të njësuar sipas legjislacionit në fuqi;

b) të ketë eksperiencë si pjesëmarrës në të paktën 5 (pesë) projekte për veprimtari arkeologjike (*survey*/ekspedita arkeologjike) brenda dhe/ose jashtë vendit, e vërtetuar nga institucioni apo drejtuesi i projektit bashkë me dokumentacionin e projektit të miratuar.

2. Për të përfituar licencë me kategorinë A2 - Sondazh arkeologjik, individi duhet:

a) të zotërojë diplomë të ciklit të dytë në arkeologji ose histori, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë apo të ketë diplomën ekuivalente, të njohur dhe të njësuar sipas legjislacionit në fuqi;

b) të jetë pjesë e ekipit të realizimit të sondazheve brenda dhe/ose jashtë vendit, e vërtetuar nga institucioni apo bashkautor i projektit bashkë me dokumentacionin e projektit të miratuar në të paktën 5 (pesë) projekte arkeologjike gërmimi-shpëtimi, projekte kërkimore-shkencore.

3. Për të përfituar licencë me kategorinë A3 - Gërmim arkeologjik, individi duhet:

a) të zotërojë diplomë të ciklit të dytë në arkeologji ose histori, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë apo të ketë diplomën ekuivalente, të njohur dhe të njësuar sipas legjislacionit në fuqi;

b) të jetë autor/bashkautor në të paktën 6 (gjashtë) projekte, brenda dhe/ose jashtë vendit, ku në 3 prej tyre të ketë qenë drejtues projekti, vërtetuar nga institucioni apo drejtuesi i projektit

bashkë me dokumentacionin e projektit të miratuar.

ose

a/1 të zotërojë diplomë "Doktor i shkencave" në fushën e arkeologjisë, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi apo të ketë njësuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin diplomën ekuivalente të lëshuar nga institucionet e huaja;

b/1 të jetë autor/ bashkautor në të paktën 4 (katër) projekte, brenda dhe/ose jashtë vendit, ku në 3 prej tyre të ketë qenë drejtues projekti, vërtetuar nga institucioni apo drejtuesi i projektit bashkë me dokumentacionin e projektit të miratuar.

4. Për të përfituar licencë me kategorinë B1 - Vëzhgim arkeologjik *(Survey)* nënujor, individi duhet:

a) të zotërojë diplomë të ciklit të dytë në arkeologji ose histori, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë apo të ketë diplomën ekuivalente, të njohur dhe të njësuar sipas legjislacionit në fuqi;

b) të zotërojë gradën e tretë të zhytësit ose superiore, të mbrojtur në një nga shkollat didaktike të njohura, si: SSI, CMAS, PADI, ose të ngjashme;

c) të zotërojë dokumentin për sigurimin e jetës në standardet e Agjencisë Ndërkombëtare për Sigurimin e Zhytëseve DAN EUROPE;

ç) të ketë eksperiencë si pjesëmarrës në të paktën 3 (tri) projekte për veprimtari arkeologjike nënujore, brenda dhe/ose jashtë vendit, e vërtetuar nga institucioni apo drejtuesi i projektit bashkë me dokumentacionin e projektit të miratuar.

5. Për të përfituar licencë me kategorinë B2 - Sondazh arkeologjik nënujor, individi duhet:

a) të zotërojë diplomë të ciklit të dytë në arkeologji ose histori, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, apo të ketë diplomën ekuivalente, të njohur dhe të njësuar sipas legjislacionit në fuqi;

b) të zotërojë gradën e tretë të zhytësit ose superiore, të mbrojtur në një nga shkollat didaktike të njohura, si: SSI, CMAS, PADI ose të ngjashme;

c) të zotërojë dokumentin për sigurimin e jetës në standardet e Agjencisë Ndërkombëtare për Sigurimin e Zhytëseve DAN EUROPE;

ç) të jetë autor/bashkautor në të paktën 3 (tri) projekte arkeologjike nënujore brenda dhe/ose jashtë vendit, e vërtetuar nga institucioni apo drejtuesi i projektit bashkë me dokumentacionin e projektit të miratuar.

6. Për të përfituar licencë me kategorinë B3 - Gërmim Arkeologjik nënujor, individi duhet:

a) të zotërojë diplomë të ciklit të dytë në arkeologji ose histori, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, apo të ketë diplomën ekuivalente, të njohur dhe të njësuar sipas legjislacionit në fuqi;

b) të zotërojë gradën e tretë të zhytësit ose superiore, të mbrojtur në një nga shkollat didaktike të njohura si: SSI, CMAS, PADI, ose të ngjashme;

c) të zotërojë dokumentin për sigurimin e jetës në standardet e Agjencisë Ndërkombëtare për Sigurimin e Zhytëseve DAN EUROPE;

ç) të jetë autor në të paktën 6 (gjashtë) projekte brenda dhe/ose jashtë vendit, ku në 3 prej tyre të ketë qenë drejtues projekti vërtetuar nga dokumenti i konfirmuar (origjinal ose fotokopje e noterizuar) nga institucioni apo drejtuesi i projektit bashkë me dokumentacionin e projektit të miratuar.

ose

a/1) të zotërojë diplomë "Doktor i shkencave" në fushën e arkeologjisë, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë të licencuara sipas dispozitave në fuqi, apo të ketë njësuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin diplomën ekuivalente, të lëshuar nga institucionet e huaja;

b/1) të zotërojë gradën e tretë të zhytësit ose superiore, të mbrojtur në një nga shkollat didaktike, të njohura si: SSI, CMAS, PADI, ose të ngjashme;

c/1) të zotërojë dokumentin për sigurimin e jetës në standardet e Agjencisë Ndërkombëtare për Sigurimin e Zhytëseve DAN EUROPE;

ç/1) të jetë autor/bashkautor në të paktën 4 (katër) projekte, brenda dhe/ose jashtë vendit, ku në 3 prej tyre të ketë qenë drejtues projekti, vërtetuar nga institucioni apo drejtuesi i projektit bashkë me dokumentacionin e projektit të miratuar.

Neni 4

Kriteret për pajisjen me licencë dhe ushtrimin e veprimtarisë arkeologjike dhe/ose veprimtarisë arkeologjike nënujore

1. Çdo subjekt individ, si dhe çdo person fizik apo juridik, i regjistruar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për veprimtarinë tregtare për ushtrimin e veprimtarisë arkeologjike dhe/ose veprimtarisë arkeologjike nënujore, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për pajisje me licencë për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore, pasi të ketë dorëzuar aplikimin e plotë

pranë sekretarisë teknike të KKTKM-së, duke plotësuar të gjitha kushtet e posaçme dhe dokumentet shoqëruese, të kërkuara në këtë vendim.

2. Veprimtaria arkeologjike dhe/ose veprimtaria arkeologjike nënujore ushtrohet vetëm nga persona fizikë ose juridikë, të regjistruar sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi për regjistrimin e biznesit.

3. Individët e pajisur me licencë mund të ushtrojnë veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore vetëm duke qenë të regjistruar si person fizik ose të punësuar si drejtues teknik pranë një personi fizik ose juridik, i regjistruar sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi për veprimtarinë tregtare.

4. Kriteret për pajisjen me licencë për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore për personin fizik janë:

a) të jetë regjistruar si person fizik me status aktiv, sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi për regjistrimin e veprimtarisë tregtare, me objekt të veprimtarisë hulumtimet arkeologjike dhe/ose arkeologjike nënujore;

b) të ketë një licencë si individ ose të ketë të punësuar si drejtues teknik individ të licencuar në fushën e veprimtarisë arkeologjike dhe/ose veprimtarisë arkeologjike nënujore;

c) të licencohet për kategorinë/kategoritë e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore që disponon individi/drejtuesi teknik.

5. Kriteret për pajisjen me licencë për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore për personin juridik janë:

a) të jetë regjistruar si person juridik me status aktiv, sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi për regjistrimin e veprimtarisë tregtare, me objekt të veprimtarisë hulumtimet arkeologjike dhe/ose arkeologjike nënujore;

b) të ketë të paktën 5 vjet përvojë si person juridik në veprimtarinë kryesore hulumtimet arkeologjike dhe/ose arkeologjike nënujore;

c) të ketë të punësuar si drejtues teknik individ të licencuar në fushën e veprimtarisë arkeologjike dhe/ose veprimtarisë arkeologjike nënujore;

ç) të licencohet për kategorinë/kategoritë e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore që disponon drejtuesi teknik.

6. Drejtues teknik është personi i cili plotëson kushtet e posaçme për kategorinë/kategoritë e licencës, të parashikuara në nenin 3, të këtij vendimi.

7. Kontrata e punësimit ndërmjet personit fizik ose juridik dhe drejtuesit teknik nuk mund të jetë më pak se 1 vit.

Neni 5

Kufizime për dhënien dhe përdorimin e licencës

1. Licenca nuk lejohet të tjetërsohet apo të trashëgohet nga një subjekt (individ, person fizik ose person juridik) tek tjetri.

2. Kur ndodh ndryshimi faktik i të dhënave të përcaktuara në licencë, të cilat kanë të bëjnë me kriteret e licencimit, pavarësisht se mund të cenojë apo jo këto kritere, subjekti (individ, person fizik, person juridik) duhet të njoftojë menjëherë sekretarinë teknike të KKTKM-së, pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (në vijim "IKTK").

3. Kur vlerësohet se dokumentet e dorëzuara nga subjekti (individ, person fizik, person juridik) provojnë përmbushjen përsëri të kritereve të licencimit, atëherë KKTKM-ja miraton ndryshimet dhe subjekti pajiset me licencën e ndryshuar. Përdorimi i licencës pezullohet për periudhën deri në miratimin e ndryshimeve dhe pajisjen me licencën e ndryshuar.

4. Anëtarët e KKTKM-së dhe punonjësit e institucioneve të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore nuk mund të aplikojnë për licencë për sa kohë mbajnë këtë detyrë.

5. Subjektet e licencuara për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore, kur emërohen anëtarë të KKTKM-së apo punësohen në institucione të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, pezullojnë licencën e tyre për sa kohë ushtrojnë një nga këto funksione.

Neni 6
Afatet e vlefshmërisë së licencës

1. Licenca për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore është pa afat për të gjitha subjektet e licencuara.

2. Subjekti, person fizik apo juridik, njofton në formë zyrtare në sekretarinë teknike të KKTKM-së, pranë IKTK-së:

a) menjëherë, kur kontrata e punësimit të drejtuesit teknik ndërpritet përpara afatit;

b) të paktën 45 (dyzet e pesë) ditë përpara mbarimit të kontratës së punësimit të drejtuesit teknik, nëse kjo kontratë do të ripërtërihet;

c) të paktën 45 (dyzet e pesë) ditë përpara mbarimit të kontratës së punësimit të drejtuesit teknik, nëse kjo kontratë nuk do të ripërtërihet.

KREU III
DOKUMENTET SHOQËRUESE PËR PAJISJEN ME LICENCË

Neni 7
Dokumente shoqëruese për pajisjen me licencë për individin

Kërkesa për pajisje me licencë për herë të parë për individin, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme të përcaktuara në këtë vendim, shoqërohet me:

a) kërkesën për pajisje me licencë, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

b) kopje të dokumentit të identifikimit;

c) CV-në e individit, ku pasqyrohet veprimtaria e tij e kryer nga marrja e diplomës, e shoqëruar me dokumentacionin justifikues, vërtetime nga subjekte publike apo private, shqiptare apo të huaja, projekte ku personi ka qenë autor dhe/ose bashkautor, certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet. Të gjitha vërtetimet dhe projektet duhet të kenë patjetër të përfshirë adresën postare dhe elektronike të subjektit që ka lëshuar vërtetimin apo që ka hartuar projektin. Vërtetimet që nuk janë sipas parashikimeve në këtë shkronjë konsiderohen si dokument i pavlefshëm për qëllimin e kërkuar;

ç) dokument që vërteton kohën/vitet e punës (libreza e punës apo dokumente të tjera që vërtetojnë kohën/vitet e punës);

d) vetëdeklarim mbi gjendjen e tij gjyqësore dhe penale;

dh) dy fotografi me përmasa 3x4 cm;

e) kopje të diplomave që zotëron, certifikata kursi apo specializimi, të noterizuara;

ë) dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për kërkesën për pajisjen me licencë për individ, për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore.

Neni 8
Dokumente shoqëruese për pajisjen me licencë për personin fizik

Kërkesa për pajisje me licencë për personin fizik, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme të specifikuara në këtë vendim, shoqërohet me:

a) kërkesën për pajisje me licencë, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

b) certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;

c) kopje të dokumentit të identifikimit të kërkuesit;

ç) CV-në e personit, ku pasqyrohet veprimtaria e tij e kryer nga marrja e diplomës, e shoqëruar me dokumentacionin justifikues, vërtetime nga subjekte publike apo private, shqiptare apo të huaja, projekte ku personi ka qenë autor dhe/ose bashkautor, certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet. Të gjitha vërtetimet dhe projektet duhet të kenë patjetër të përfshirë adresën postare dhe elektronike të subjektit që ka lëshuar vërtetimin apo që ka hartuar projektin, në të kundërt dokumenti nuk do të konsiderohet si dokument justifikues për eksperiencën. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të përkthehen sipas rregullave të parashikuara në nenin 135, të ligjit nr. 110/2018, "Për noterinë";

d) vetëdeklarimin e personit fizik mbi gjendjen e tij gjyqësore dhe penale;

dh) dy fotografi me përmasa 3x4 cm;

e) vetëdeklarim nga drejtuesi teknik, për:

i. gjendjen gjyqësore dhe penale;

ii. gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në persona fizikë apo juridikë të tjerë;

iii. marrëdhënien e tij të punës me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura, apo persona juridikë publikë të tjerë;

ë) në rastin e punësimit të drejtuesit teknik, kontratën e lidhur midis personit fizik dhe drejtuesit teknik në fushën e veprimtarisë arkeologjike dhe/ose nënujore;

f) dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për kërkesën për pajisjen me licencë për personin fizik për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore.

Neni 9

Dokumente shoqëruese për pajisje me licencë për personin juridik

Kërkesa për pajisje me licencë për personin juridik, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme të specifikuara në këtë vendim, për secilën kategori, shoqërohet me:

a) kërkesë të përfaqësuesit ligjor të personit juridik, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

b) certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;

c) vetëdeklarimin mbi gjendjen gjyqësore dhe penale (të anëtarëve të organit administrativ, aksionarit ose ortakut, të personit që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda personit juridik);

ç) kontratë punësimi midis përfaqësuesit ligjor dhe drejtuesit teknik në fushën e veprimtarisë arkeologjike dhe/ose nënujore;

d) vetëdeklarim i drejtuesit teknik në fushën e veprimtarisë arkeologjie dhe/ose nënujore në cilësinë e drejtuesit/drejtuesve teknikë, për:

i. gjendjen e tij gjyqësore dhe penale;

ii. gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në persona juridik të tjerë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e arkeologjisë;

iii. marrëdhënien e tij të punës me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura apo persona juridikë të tjerë publikë;

dh) dokumentacionin e drejtuesit teknik të punësuar, që provon plotësimin e kushteve të posaçme për kategorinë/kategoritë e licencës, të parashikuara në nenin 3, të këtij vendimi;

e) dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për kërkesën për pajisjen me licencë për personin juridik për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore.

Neni 10

Dokumente shoqëruese për shtesa në kategori dhe ndryshim të licencës

1. Kërkesa për pajisje me shtesa në kategori dhe ndryshim të licencës, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme e të përgjithshme, të specifikuara në këtë vendim, shoqërohet me:

a) kërkesën për pajisje me shtesa në kategori dhe ndryshim të licencës, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

b) dokumentacionin përkatës që provon përmbushjen e kritereve;

c) dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për shtesa në kategori dhe ndryshim të licencës.

2. Në rastin kur ndryshimi që kërkohet ka lidhje me shtesa në kategori me qëllim pajisjen me licencë të re, subjekti duhet të dorëzojë licencën ekzistuese. Licenca ekzistuese shpallet e pavlefshme dhe lëshohet licencë e re me shtesat. Licenca e shpallur e pavlefshme shënjohet nga sekretaria teknike e KKTKM-së me prerje në anë dhe arkivohet në dosjen e subjektit.

3. Në rastin kur ndryshimi që kërkohet ka lidhje me ndërrimin e drejtuesit teknik, përfaqësuesve ligjorë, ndryshim të emrit apo selisë, mbarimin e afatit të kontratës së punësimit apo ripërtëritjen e afatit të kontratës së punësimit, me qëllim pajisjen me licencë të re, subjekti duhet të dorëzojë licencën ekzistuese. Licenca ekzistuese shpallet e pavlefshme dhe lëshohet licencë e re. Licenca e shpallur e pavlefshme shënjohet nga sekretaria teknike e KKTKM-së me prerje në anë dhe arkivohet në dosjen e subjektit.

Neni 11

Dokumente shoqëruese për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses

1. Kërkesa për pajisjen me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme, të specifikuara në këtë vendim, shoqërohet me:

a) kërkesën për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

b) dy fotografi për dokument;

c) dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për kërkesën për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtim të ekzistueses.

2. Në rastin kur kërkesa ka lidhje me zëvendësimin e licencës së dëmtuar me qëllim pajisjen me licencë të re, subjekti duhet të dorëzojë licencën ekzistuese të dëmtuar.

3. Licenca e dëmtuar dhe ajo e humbur shpallet e pavlefshme dhe lëshohet licencë e re, me të dhëna të njëjta dhe me datë lëshimi të re.

KREU IV
PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS, DHËNIEN, PEZULLIMIN OSE REVOKIMIN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË ARKEOLOGJIKE DHE VEPRIMTARINË ARKEOLOGJIKE NËNUJORE

Neni 12
Dorëzimi dhe pranimi i kërkesave

1. Kërkesa për licencë dhe dokumentet shoqëruese të saj dërgohen nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit për veprimtari arkeologjike dhe veprimtari arkeologjike nënujore, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*.

2. Dokumentet për licencë, që ngarkohen në sistem, duhet të jenë:

a) origjinale ose kopje të noterizuara të origjinalit;

b) në gjuhën shqipe ose të përkthyera në gjuhën shqipe nga përkthyes zyrtarë dhe të njësuara me origjinalin nga noteri;

c) për rastet e dokumenteve të huaja, kopje të vërtetuara nga një autoritet publik i juridiksionit të huaj (zyrtar/noter). Është detyrim të vërtetohet ekzistenca e tyre si zyrtarë apo noterë, nëpërmjet legalizimit apo apostilimit, sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

3. Pagesa e tarifës për përfitimin e licencës kryhet nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit për veprimtari arkeologjike dhe arkeologjike nënujore, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*, ose pranë çdo banke të nivelit të dytë, nëpërmjet formularit të faturës për arkëtim.

4. Paraqitja fizike e një apo disa dokumenteve pranë sportelit unik do të kryhet vetëm në këto raste:

a) për dorëzimin e fotografive të individit që aplikon, të cilat dorëzohen fizikisht nga kërkuesi, deri në momentin e tërheqjes së formularit të licencës;

b) për dorëzimin e licencës paraardhëse, në rastet e parashikuara në këtë vendim;

c) kur kërkohet verifikim i dokumentit/dokumenteve nga sekretaria teknike e KKTKM-së.

ç) për çdo rast, i cili nuk njihet ose nuk mund të parashikohet në momentin e miratimit të këtij vendimi.

Neni 13
Shqyrtimi i kërkesave

1. Kërkesa për dhënien ose revokimin e licencës për shtesa në kategori dhe ndryshim të licencës dhe për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses, bashkë me dokumentet shoqëruese të saj sipas këtij vendimi, administrohen nga sporteli unik dhe sekretaria teknike e KKTKM-së, pranë IKTK-së.

2. Procedura e administrimit të kërkesës dhe shqyrtimit të saj deri në vendimmarrje me miratim ose jo të kërkesës realizohet sipas rregullave të funksionimit të KKTKM-së, përcaktuar në "Rregulloren për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, sekretarisë teknike dhe sportelit unik të saj", miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

3. KKTKM-ja merr vendim mbi kërkesën sipas rastit, licencim ose revokim të licencës për shtesa në kategori dhe ndryshim të licencës dhe për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses, brenda 45 ditëve nga regjistrimi i kërkesës.

4. Ndaj vendimit të KKTKM-së mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

5. Sekretaria teknike bën shpërndarjen e licencave të interesuarve jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e urdhrit të ministrit, nëpërmjet shërbimit postar ose licencat tërhiqen nga vetë personi i licencuar apo nga persona të

autorizuar me akt noterial për të kryer një veprim të tillë apo personat e autorizuar nga personi juridik. Kopja e autorizimit depozitohet në dosjen që arkivohet.

6. Licenca e miratuar për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore për shtesa në kategori/nënkategori dhe ndryshim të licencës për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses, si dhe çdo vendim për pezullim apo revokim të licencës regjistrohet në Regjistrin e Licencave për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, i cili administrohet nga IKTK-ja, si dhe në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 14
Detyrimi i formimit të vazhdueshëm

1. Individi i licencuar ka detyrimin të kryejë formimin e vazhdueshëm ose të marrë kreditet në përputhje me pikat 2 dhe 3, të nenit 137, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë".

2. Brenda datës 31 janar të çdo viti, individi i licencuar raporton pranë sekretarisë teknike mbi plotësimin e krediteve për vitin ushtrimor paraardhës, sipas parashikimit të pikës 1, të këtij neni.

Neni 15
Revokimi dhe pezullimi i licencës

1. Licenca revokohet në rastet e parashikuara në pikën 3, të nenit 137, pikën 1, të nenit 138, dhe pikën 7, të nenit 157, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë".

2. Licenca revokohet edhe në rastin kur personi fizik ose personi juridik mbyll aktivitetin. Në këtë rast, subjekti paraqet pranë sekretarisë teknike të KKTKM-së dokumentacionin, si më poshtë:

a) Njoftim me shkrim nga përfaqësuesi ligjor për mbylljen e aktivitetit;

b) Dorëzimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore që disponon;

c) Dokument vërtetues nga QKB-ja për çregjistrimin e subjektit nga Regjistri Tregtar.

3. Për çdo rast të konstatuar, IKTK-ja harton një raport vlerësimi të fakteve dhe ia kalon për shqyrtim KKTKM-së, që merr vendim për revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore.

4. Përdorimi i licencës pezullohet në rastet kur titullari i saj ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit ose ka ndonjë pengesë tjetër ligjore me ushtrimin e funksioneve publike, në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar.

5. Licenca për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore pezullohet me vendim të KKTKM-së për çdo konstatim të rasteve të përmendura në këtë nen dhe që nuk përbëjnë shkak për revokim për periudhën kohore që ekziston shkaku që ka çuar në pezullim.

6. Kundër vendimit për revokimin ose pezullimin e licencës mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

KREU V
DISPOZITA KALIMTARE

Neni 16

1. Për çdo individ, person fizik ose person juridik, të licencuar në arkeologji, të cilit i është miratuar licenca nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë ose nga KKTKM-ja përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, licenca do të konsiderohet e vlefshme deri 6 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Brenda këtij afati subjektet duhet të bëjnë rinovimin e licencave me formatin e ri të kategorive, si dhe në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore. Pas këtij afati, licencat e parinovuara janë të pavlefshme.

2. Të gjitha subjektet, të cilat kanë paraqitur kërkesë për licencë për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore dhe nuk janë shqyrtuar nga KKTKM-ja përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi duhet të dorëzojnë dokumentacionin plotësues për të provuar plotësimin e kushteve për licencim sipas këtij vendimi, brenda afatit 31.12.2020.

3. Të gjitha kërkesat për licencë për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore, si dhe aktet formale në lidhje

me to bëhen me pagesë, sipas tarifave të miratuara me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrit përgjegjës për financat.

4. Ngarkohet KKTKM-ja për miratimin e formatit të licencave, të cilat konsiderohen dokumente me vlerë që i nënshtrohet prodhimit të posaçëm.

5. Licenca e miratuar për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore, si dhe çdo vendim për revokim dhe pezullim të licencës regjistrohet në regjistrin e licencave në fushën e arkeologjisë, i cili administrohet nga IKTK-ja, si dhe në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

6. Të gjitha kërkesat për licenca për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore dhe dokumentacioni shoqërues do të dërgohen në formë fizike nëpërmjet shërbimit postar pranë sportelit unik/sekretarisë teknike të IKTK-së deri në kalimin e të gjithë procedurës në sistemin elektronik për aplikimin *online* në portalin *e-Albania*.

FORMULAR APLIKIMI

Licencë për veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale

Institucioni përgjegjës: *Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore*

1. APLIKUESI					
STATUSI I APLIKUESIT	*INDIVID*		*PERSON FIZIK*	*PERSON JURIDIK*	
2. INFORMACION SPECIFIK (KUR APLIKUESI ËSHTË INDIVID)					
INDIVIDI:	*Emri*		*Mbiemri*		
ID:					
Nr. tel. / cel.:					
Email:					
Adresa:					
2/1. INFORMACION SPECIFIK (KUR APLIKUESI ËSHTË PERSON FIZIK / PERSON JURIDIK)					
Emri i subjektit:					
NIPT:					
Administratori:	*Emri*		*Mbiemri*		
ID -Administratori:					
Nr. tel. / cel.:					
Email:					
Adresa:					
3. INFORMACION SPECIFIK MBI DREJTUESIN TEKNIK (KUR APLIKUESI ËSHTË PERSON FIZIK/PERSON JURIDIK)					
Drejtuesi teknik (DT):	*Emri*		*Mbiemri*	*Tel.*	
Nr. i licencës së DT:					
4. INFORMACION SPECIFIK MBI LICENCËN E KËRKUAR					
Kategoria e veprimtarisë arkeologjike nëntokësore dhe veprimtarisë arkeologjike nënujore për të cilën kërkohet licenca:				Aplikim i ri	Aplikim për shtesa
	A. Veprimtari arkeologjike nëntokësore	A1. Vëzhgim arkeologjik *(Survey)*			
		A2. Sondazhe arkeologjike			
		A3. Gërmim arkeologjik			
	B. Veprimtari arkeologjike nënujore	B1. Vëzhgim arkeologjik *(Survey)* nënujor			
		B2. Sondazh arkeologjik nënujor			
		B3. Gërmim arkeologjik nënujor			
Ndryshime të licencës:		Rinovim afati			
		Ndryshim përfaqësuesi ligjor			
		Ndryshim drejtuesi teknik			
		Ndryshim të emrit apo selisë			
Zëvendësim të licencës ekzistuese:		Humbje			
		Dëmtim			
Veprimtari specifike (punët e ngjashme për çdo kategori aplikimi):	1				
	2				
	3				
	4				
	5				
	6				
	7				
Vendi i kryerjes së veprimtarisë:					
6. KLAUZOLA DEKLARATIVE					
Vetëdeklarim mbi përgjegjësinë mbi veprimtarinë që do të kryejë individi					
Unë i/e nënshkruari/a _____ deklaroj se: - Të dhënat e deklaruara dhe dokumentet e dorëzuara janë të vërteta; - Drejtuesi teknik nuk punon në një shoqëri tjetër dhe nuk është në marrëdhënie pune me shtetin; - Subjekti njeh dhe pranon kriteret dhe detyrimet e licencimit.					
Vetëdeklarim mbi përgjegjësinë mbi veprimtarinë që do të kryejë subjekti					
Unë i/e nënshkruari/a _____ me cilësinë e administratorit të subjektit "_____", deklaroj se: - Të dhënat e deklaruara dhe dokumentet e dorëzuara janë të vërteta. - Drejtuesi teknik nuk punon në një shoqëri tjetër dhe nuk është në marrëdhënie pune me shtetin. - Subjekti njeh dhe pranon kriteret dhe detyrimet e licencimit.					
Vetëdeklarim mbi përgjegjësinë mbi veprimtarinë që do të kryejë individi (drejtues teknik)					

1. Unë i/e nënshkruari/a _____, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklarim i pavërtetë, deklaroj se: - Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me kategorinë e licencës ku kërkoj të licencohem; ose - Kam çështje gjyqësore të hapur në Gjykatën e Rrethit _____ (shoqëruar me motivin e çështjes) ose/dhe jam në ndjekje penale nga organi i Prokurorisë së Rrethit _____ (shoqëruar me motivin e ndjekjes). 2. Unë i/e nënshkruar/a _____, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklarim i pavërtetë, deklaroj se: - Nuk kam asnjë penalizim nga strukturat shtetërore të ngarkuara për inspektimin ndërtimor e urbanistik; ose - Kam penalizim nga struktura shtetërore qendrore ose vendore _____ (shoqëruar me motivin e penalizimit).
Vetëdeklarim mbi përgjegjësinë mbi veprimtarinë që do të kryejë subjekti
1. Unë i/e nënshkruari/a _____me cilësinë e administratorit të subjektit "_____", në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklarim i pavërtetë, deklaroj se: - Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me kategorinë e licencës ku kërkoj të licencohem; ose Kam çështje gjyqësore të hapur në Gjykatën e Rrethit _____ (shoqëruar me motivin e çështjes) ose/dhe jam në ndjekje penale nga organi i Prokurorisë së Rrethit _____ (shoqëruar me motivin e ndjekjes). 2. Unë i/e nënshkruari/a _____ me cilësinë e administratorit të subjektit "_____", në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklarim i pavërtetë, deklaroj se: - Nuk kam asnjë penalizim nga strukturat shtetërore të ngarkuara për inspektimin ndërtimor e urbanistik; ose - Kam penalizim nga struktura shtetërore qendrore ose vendore _____ (shoqëruar me motivin e penalizimit).
Autorizimi i mëposhtëm është vullnetar
Autorizoj institucionin të përpunojë të dhënat e mia personale (emër, mbiemër, numër telefoni ose *email*) të mbledhura më sipër, me qëllim zhvillimin e sondazheve të automatizuara për marrjen e opinionit tim, në lidhje me cilësinë e ofrimit të shërbimit.

7. DOKUMENTACIONI I NGARKUAR	
1. Kontrata e punës ndërmjet subjektit (personi fizik apo personi juridik) dhe drejtuesit teknik të licencuar	
2. Deklaratë e drejtuesit teknik	
3. Mandatpagesa	
4. Dokumente të tjera	

8. DOKUMENTET / VERIFIKIMET / MIRATIMET QË SIGUROHEN NGA BASHKËVEPRIMI NDËRINSTITUCIONAL
1. Ekstrakt regjistrim biznesi nga QKB ose vendimin e regjistrimit në gjykatë
2. Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të tatimore, taksave deri në momentin e paraqitjes së kërkesës *(nga bashkia dhe drejtoritë tatimore)*
3. Fotokopje e licencës personale të drejtuesit teknik
4. Verifikim / informacion për veprimtarinë arkeologjike të individëve nga DRTK-ja
5. Verifikim / informacion për veprimtarinë arkeologjike të subjektit nga DRTK-ja *(jo për aplikim për herë të parë)*

9. BAZA LIGJORE E KËTIJ SHËRBIMI
1. Ligji nr. 27/2018, datë 17.5.2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë"
2. VKM nr.___, datë __.__.2020, "Për përcaktimin e kushteve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurave për shqyrtimin dhe revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore"

10. NJOFTIMI						
Marrja e informacionit:		Postë		*Email*	*e-Albania*	Sportel
Email (për njoftimin):						
Afati i njoftimit:	Jo më vonë se 10 ditë nga vendimi i KKTKM-së					

UDHËZIM
Nr. 24, datë 8.10.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 13, DATË 22.5.2019, "PËR PROCEDURAT E PRANIMIT E TË EMËRIMIT TË MËSUESIT NË NJË VEND TË LIRË PUNE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE PËR ADMINISTRIMIN E PORTALIT 'MËSUES PËR SHQIPËRINË'", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 1, të nenit 60, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 13, datë 22.5.2019, të ndryshuar, pika 3/1, e kreut 10, ndryshon si më poshtë:

"3/1. Drejtuesit e Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar nuk mund të pranojnë kërkesat për dorëheqje të drejtorëve dhe nëndrejtorëve të institucioneve arsimore, pa i sistemuar më parë në vende pune të lira dhe me ngarkesë të plotë, brenda së njëjtës Zyrë Vendore të Arsimit Parauniversitar, me përjashtim të rasteve kur drejtorët apo nëndrejtorët largohen nga sistemi arsimor sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk kanë 5 (pesë) vite eksperiencë punë si drejtor/nëndrejtor apo mësues, apo nuk plotësojnë kriteret ligjore për të qenë mësues. Rastet e dorëheqjeve të drejtorëve dhe nëndrejtorëve të institucioneve arsimore, me kërkesën për sistemim si mësues, i paraqiten menjëherë komisionit të lëvizjeve paralele në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar, gjatë apo ndërmjet viteve mësimore, komision i cili ia propozon kërkesat drejtorit të institucionit arsimor ku lirohet vendi më i parë i punës. Drejtorët dhe nëndrejtorët që kanë paraqitur kërkesën për dorëheqje, nuk mund të refuzojnë më shumë se 3 (tri) vende pune si mësues, të propozuara nga komisioni, dhe emërimi u bëhet pa afat, nga drejtori i institucionit arsimor përkatës.".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASh), Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi

SEKSIONI I DYTË
ÇËSHTJA KASMI KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 1175/06)

VENDIM

Neni 1, P 1 – Kontroll i përdorimit të pronës – Pamundësia e kërkuesit të rimerrte në zotërim pronën e zënë nga qiramarrësit, për më shumë se 13 vjet, në kuadër të mbrojtjes së strehimit të qiramarrësve të prekur nga kthimi i pronave të shpronësuara ose të shtetëzuara tek ish-pronarët – Janë marrë në konsideratë rrethanat sociale dhe ekonomike në kohën respektive – Skema synohej të ishte për një kohëzgjatje të kufizuar, me përgjegjësinë e Shtetit për të siguruar zgjidhje alternative për strehim për qiramarrësit e prekur – Marrëveshjet e qiramarrjes parashikuar nga ligji – Marrëveshja e pakufizuar në kohë – Mungesa e mekanizmave të duhur në mbrojtje të së drejtës së kërkuesit për të zgjidhur marrëveshjet e qiramarrjes - Vlerë e ulët e qirasë e përcaktuar nga ligji, duke mos lejuar indeksimin e saj ndaj inflacionit – Mungesa e masave konkrete të autoriteteve për të garantuar strehim alternativ për qiramarrësit – Periudhë e gjatë pasigurie – Barra e një situate komplekse nga aspekti social mbi kërkuesin

STRASBURG
23 qershor 2020

Ky vendim do të bëhet i formës së prerë, sipas rrethanave të parashikuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

VENDIMI KASMI KUNDËR SHQIPËRISË

Në çështjen Kasmi kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i dytë), e mbledhur si një Dhomë e përbërë nga:

Robert Spano, kryetar,
Paul Lemmens,
Valeriu Griţco,
Egidijus Kūris,
Jon Fridrik Kjølbro,
Stéphanie Mourou-Vikström,
Darian Pavli, gjyqtarë
dhe Stanley Naismith, sekretar i Seksionit,

pasi diskutoi me dyer të mbyllura më datë 10 prill 2018 dhe 26 maj 2020,

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja filloi me një kërkesë (nr. 1175/06) kundër Republikës së Shqipërisë, paraqitur në Gjykatë me datë 19 dhjetor 2005, mbështetur në nenin 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa"), nga një shtetas shqiptar, z. Gëzim Kasmi (Kërkuesi).

2. Kërkuesi u përfaqësua nga z. S. Dodbiba, një avokat i cili ushtron aktivitetin në Tiranë. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjenti i saj, në atë kohë, znj. E. Hajro nga Avokatura e Shtetit.

3. Z. Ledi Bianku, pas përfundimit të mandatit të tij si gjyqtari i zgjedhur për Shqipërinë, u tërhoq nga çështja (rregulla 28 e Rregullave të Gjykatës). Z. Darian Pavli, pasi mori detyrën si gjyqtari i zgjedhur për Shqipërinë, zuri vendin e tij (rregulla 26 § 1(a)).

4. Sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, kërkuesi pretendonte se kishte pasur një shkelje të të drejtave të tij të pronës, pasi ai nuk kishte mundur të rimerrte në pronësi shtëpinë e tij.

5. Më 5 shkurt 2009, kërkesa iu komunikua Qeverisë.

FAKTET

6. Kërkuesi lindi në vitin 1942 dhe jeton në Tiranë.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

A. Konteksti përkatës

7. Gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri, familjet, në përgjithësi, jetonin në mjedise nën pronësinë e Shtetit, të lëna si banesa, në përputhje me marrëveshjet e qiradhënieve për banim, të cilat

lidheshin midis qiramarrësit dhe Ndërmarrjes Komunale të asaj kohe për Banesa nën pronësinë e Shtetit (Ndërmarrja Komunale për Banesa). Banesat private, të cilat kishin kaluar në pronësinë e Shtetit, me anë të legjislacionit për shtetëzim, i kaluan nga Qeveria e asaj kohe familjeve – anëtarët e të cilave, si rregull, në atë kohë punonin për Shtetin – në mbështetje të marrëveshjeve të qiramarrjes.

8. Në vitin 1992, pas rënies së regjimit komunist, hyri në fuqi ligji i privatizimit, sipas të cilit banesat nën pronësinë e Shtetit, përveç atyre të cilat më herët kishin qenë prona private, do t'i nënshtroheshin privatizimit. Dispozitat përkatëse të aktit të privatizimit parashikohen në paragrafët 21–24 më poshtë.

9. Në vitin 1993, hyri në fuqi ligji për kthimin dhe kompensimin e pronës (ligji i pronës), sipas të cilit ish-pronarëve ose trashëgimtarëve të tyre u jepej e drejta të kërkonin kthimin e pronave të shpronësuara ose të shtetëzuara, si edhe kompensimin në vend të kthimit. Megjithatë, apartamentet në ato prona shpesh ishin të zënë nga qiramarrësit, të cilët kishin lidhur një marrëveshje qiramarrje me Shtetin. Dispozitat përkatëse të ligjit të pronës paraqiten në paragrafët 41–46 më poshtë.

B. Rrethanat e çështjes specifike

1. Procedimet administrative në lidhje me kthimin e pronës së kërkuesit

10. Babai i kërkuesit zotëronte dy shtëpi që gjendeshin në Tiranë dhe secila prej tyre përbëhej nga katër dhoma, një dhomë ngrënie dhe oborri përkatës. Në një datë të papërcaktuar, në vitet 1950, të dyja pronat u shtetëzuan nga Shteti dhe më pas u morën me qira nga familje.

11. Pas hyrjes në fuqi të ligjit të pronës në vitin 1993, në një datë të papërcaktuar – me shumë mundësi në vitin 1994 ose 1995 – babai i kërkuesit paraqiti një kërkesë pranë Komisionit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës, Tiranë (Komisioni) për kthimin e shtëpive.

12. Konstatohet se me anë të një vendimi të datës 27 shtator 1995, për të cilin nuk është dorëzuar asnjë kopje nga palët, Komisioni i njohu babait të kërkuesit të drejtat e pronësisë ndaj shtëpive.

13. Më 15 gusht 1997, pas vdekjes së babait të kërkuesit, e drejta e tij dhe e motrave dhe e vëllezërve të tij ndaj pronës u regjistruan në regjistrin e pronave.

2. Procedimet gjyqësore në lidhje me nxjerrjen e qiramarrësve që kishin zënë pronën e kërkuesit

14. Në një datë të paspecifikuar, duke qenë se kërkuesi nuk mund të rifitonte pronësinë e njërës prej shtëpive, duke qenë se ajo ishte e zënë prej qiramarrësve, ai paraqiti një padi civile në Gjykatën e Rrethit Tiranë (Gjykata e Rrethit), me të cilën kërkonte nxjerrjen e tyre. Sipas këndvështrimit të tij, qiramarrësit nuk gëzonin ndonjë të drejtë prone ndaj shtëpisë, ata nuk i kishin paguar atij qira dhe ligjërisht nuk ishin të pastrehë. Ai argumentoi se duke qenë se ishte pronari i ligjshëm i shtëpisë, zënia e shtëpisë nga qiramarrësit kishte cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtat e tij ndaj pronës, mbrojtja e të cilave garantohej nga Kushtetuta dhe Konventa.

15. Më 17 mars 2003, Gjykata e Rrethit Tiranë la në fuqi padinë e kërkuesit. Ajo konstatoi se njëri prej qiramarrësve, më konkretisht J.D., nuk zotëronte një autorizim të ligjshëm mbajtjeje në zotërim, për të vijuar të zinte pronën e kërkuesit. Në lidhje me qiramarrësit e tjerë, gjykata deklaroi se dy prej tyre, konkretisht B.S. dhe M.S., kishin jetuar jashtë vendit për të paktën pesë vjet dhe njëri prej tyre, më konkretisht F.S., kishte marrë strehim nga Shteti. Gjykata i urdhëroi të gjithë qiramarrësit që të lironin shtëpinë.

16. Qiramarrësit apeluan në Gjykatën e Apelit Tiranë (Gjykata e Apelit), e cila më 23 prill 2004 prishi pjesërisht vendimin e Gjykatës së Rrethit për sa kishte të bënte me J.D., B.S. dhe M.S. Gjykata e Apelit konstatoi se ata qiramarrës e kishin zënë shtëpinë që prej viteve 1980. Në lidhje me J.D., gjykata konstatoi se ai ishte ligjërisht i pastrehë dhe kishte fituar të drejtën për qiramarrje që prej vitit 1993. Në lidhje me B.S. dhe M.S., gjykata konstatoi se duke qenë se ata kishin jetuar jashtë vendit si emigrantë ekonomikë për dy vitet e fundit dhe nuk kishin vendosur vendbanim të përhershëm atje, ata nuk e kishin braktisur banesën e tyre në Shqipëri. Gjykata e Apelit, megjithatë, la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit për sa kishte të bënte me F.S. dhe e urdhëroi atë qiramarrës të lironte një dhomë në katin përdhes.

17. Kërkuesi apeloi në Gjykatën e Lartë duke parashtruar se J.D. nuk kishte pasur një autorizim të ligjshëm për zënien e pronës, sipas të cilit ai të mund të lidhte një marrëveshje qiramarrjeje. Në vijim, ai argumentoi se B.S. dhe M.S. kishin dhjetë vjet që jetonin jashtë vendit.

18. Më 19 korrik 2005, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit. Gjykata e Lartë njohur të drejtat e padiskutueshme të kërkuesit ndaj shtëpisë. Megjithatë, për sa i përket J.D., Gjykata e Lartë konstatoi se duke qenë se në bazë të ligjit ai ishte i pastrehë, ligjërisht ai kishte zënë njërin prej apartamenteve, sipas një autorizimi shfrytëzimi, që prej vitit 1986. Në vijim, ai mori një vendim gjykate të formës së prerë në vitin 1993, vendim i cili mbeti i pavënë në fuqi, duke i dhënë të drejtën të vijonte qiramarrjen. Gjykata, në vijim gjykoi se edhe pse B.S. dhe M.S. jetonin jashtë vendit, ata po e zinin në mënyrë të ligjshme apartamentin me arsyen se ishin ligjërisht të pastrehë.

19. Gjykata e Lartë, në vijim deklaroi se për sa i përket nenit 14, të ligjit të pronës 1993, i cili parashikonte marrëdhënien midis ish-pronarëve dhe qiramarrësve (shih paragrafin 42 më poshtë) palët ndërgjygjëse kishin hapësira ligjore për rregullimin e marrëdhënieve të tyre.

3. Zhvillime të mëtejshme pasi çështja iu komunikua Qeverisë

20. Më 20 maj 2010, kërkuesi informoi Gjykatën se qiramarrësit të cilët jetonin në pronën e tij, pa i specifikuar emrat e tyre, kishin vdekur dhe se ai e kishte marrë shtëpinë në pronësi.

II. KUADRI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE LIGJORE

A. Kuadri i brendshëm ligjor, në lidhje me privatizimin e banesave në pronësinë e Shtetit dhe mbështetja e Shtetit për familjet e pastreha

1. Ligji për privatizimin e banesave shtetërore (ligji i privatizimit – ligji nr. 7652, i datës 23 dhjetor 1992, i ndryshuar)

21. Ligji i privatizimit synonte të privatizonte banesat shtetërore dhe të krijonte një treg të lirë për strehimin, duke bërë të mundur në këtë mënyrë që qiramarrësit në këto banesa të bëheshin pronarë. Familjet që jetonin në banesat shtetërore, sipas marrëveshjes së qiramarrjes, mund t'i blinin ato banesa dhe të bëheshin pronarë që do t'i nënshtroheshin një pakete veprimesh, të tilla si pagesa e çmimit të plotë të privatizimit dhe regjistrimi i pronës në zyrën përkatëse për regjistrimin e tokës.

22. Neni 16 parashikon se të pastrehët kishin të drejtën të merrnin hua nga institucionet financiare për të zgjidhur nevojat e tyre të strehimit. Pagesat e interesit do të barteshin nga Shteti me anë të Entit Kombëtar të Banesave (EKB).

23. Neni 21 parashikon se banesat shtetërore, të cilat më herët kishin qenë prona private nuk do t'i nënshtroheshin privatizimit sipas ligjit për privatizimin. Duke qenë se qiramarrësit do të vijonin të paguanin qira, neni 19 parashikonte se qiratë për banesat shtetërore, të cilat më herët kishin qenë prona private, do të liroheshin prej muajit dhjetor 1995. Neni 21/1, i variantit të vitit 1994, parashikonte se banesat shtetërore, të cilat më herët kishin qenë prona private, për të cilat nuk ishte paraqitur asnjë kërkesë për kthim, sipas ligjit të pronës 1993, do të vijonin të administroheshin dhe të mirëmbaheshin nga EKB-ja.

24. Sipas nenit 25, Shteti do t'i siguronte jetesën qiramarrësve në banesat që u përkisnin ish-pronarëve, dhe që do t'i lironin banesat sepse ato do t'i ktheheshin ish-pronarëve, në strehët me qira që do të ndërtoheshin në të ardhmen.

25. Ligji i privatizimit, veprimi i të cilit zgjerohej shpesh, të paktën deri më 31 dhjetor 1995, u shfuqizua me hyrjen në fuqi të ligjit për programet sociale, i ndryshuar në vitin 2007 (shih paragrafin 37 më poshtë).

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 11/1993

26. Pas kërkesës për shqyrtim kushtetues të ligjit për pronat, me argumentin se diskriminonte qiramarrësit të cilët kishin zënë pronat që do t'i ktheheshin ish-pronarëve, kërkesë që u paraqit në Gjykatën Kushtetuese nga 265 qiramarrës, të cilët kishin zënë ish-pronat private, më 27 gusht 1993, Gjykata Kushtetuese e kundërshtoi kërkesën si të pabazuar në fakte.

"Gjykata [Kushtetuese] konstaton se [ligji i privatizimit] dhe [ligji për pronën] rregullojnë problemet e privatizimit të banesave shtetërore dhe kthimin e pronave ish-pronarëve ose kompensimin e tyre.

Sipas të dyja ligjeve, qiramarrësit e banesave shtetërore kanë të drejtën t'i zotërojnë ato privatisht, sipas kushteve të parashikuara në ligj. Për të zgjidhur nevojat e tyre të strehimit, qiramarrësve të banesave të cilat u janë kthyer ish-pronarëve, u është dhënë e drejta të marrin hua nga institucionet financiare, pagesa e interesit të të cilave do të mbulohet nga Shteti, siç parashikohet shprehimisht në nenin 16 të ligjit ose, në një variant tjetër, ata do të strehohen si qiramarrës në njësitë e strehimit të cilat do të ndërtohen nga Shteti në përputhje me nenin 25 të këtij ligji.

Zgjidhjet e ndryshme për problemet e strehimit, të cilat u përkasin këtyre kategorive qiramarrësish nuk lindin prej ndonjë lloj diskriminimi midis tyre, por janë rezultat i statusit të ndryshëm që ata gëzojnë: të parët janë qiramarrësit e banesave shtetërore, të dytët janë qiramarrësit e banesave që u janë kthyer ish-pronarëve.

Kërkesa e ankuesve se janë diskriminuar [në mbështetje të faktit se i përkasin kategorisë së qiramarrësve, të cilët kanë zënë ish-pronat private], sipas ligjit të privatizimit dhe ligjit të pronës është e pabazuar në fakte."

2. Kontributi i Shtetit në Ligjin për Familjet e Pastreha ("Kontributi në Ligjin për Familjet e Pastreha" – ligji nr. 8030 i datës 15 nëntor 1995, i ndryshuar me Ligjin nr. 8647 të datës 24 korrik 2000)

27. Sipas nenit 1, ligji synonte të përcaktonte detyrimet e Shtetit për familjet e pastreha (që janë familjet të cilat mbetën të pastreha si rezultat i hyrjes në fuqi të ligjit për privatizimin), duke u dhënë një kuotë për strehim dhe hua. Gjithashtu, ai synonte t'u jepte mundësinë të përfitonin nga tregu i lirë i pronës.

28. Sipas nenit 2, familjeve të pastreha u jepej e drejta të merrnin një kuotë për strehim nga Shteti. Sipas nenit 6, kuota mund të përdorej për të blerë godina nga Shteti ose persona privatë, për të blerë një sipërfaqe trualli për ndërtimin e një banese nga Shteti ose personat privatë dhe për të [paguar qiranë kontraktuale për përdorimin e një banese shtetërore ose private. Me shterimin e kuotës, statusi i familjes së pastrehë do të revokohej. Për më tepër, familjeve të pastreha u ishte dhënë e drejta për një hua nga Banka e Kursimeve e asaj kohe, për ndërtimin ose blerjen e një banese, sipas parashikimit në nenet 7 dhe 8.

29. Neni 2 i ndryshuar, në vijim parashikonte se familjet e pastreha, të cilat jetonin në banesa që u përkisnin ish-pronarëve do të trajtoheshin si një kategori me prioritet. Shteti do t'u siguronte strehim me anë të EKB-së. Privatizimi i këtyre njësive strehuese do të kryhej në përputhje me ligjin e privatizimit, duke i shtuar tarifës së shitjes indeksin e korrigjimit të çmimeve.

30. Seksioni 11 parashikonte nocionin e liberalizimit të qirave, të cilat do të duhej të paguheshin nga qiramarrësit e pastrehë, që jetonin në banesa të cilat u përkisnin ish-pronarëve. Ai përcaktonte raportin e qirasë së pagueshme nga qiramarrësi dhe nga Shteti. Qiramarrësit do të duhej të paguanin një qira të ngjashme me atë të paguar për banesat shtetërore, e përllogaritur në përputhje me përmasën e pronës që zinin. Shteti ishte i detyruar të paguante vlerën e mbetur të qirasë, të përllogaritur në përputhje me qiratë e paguara për banesat shtetërore dhe përmasën e pronës. Në vijim, ky nen u shfuqizua nga Gjykata Kushtetuese në vitin 1997 (shih paragrafin 35 më poshtë).

31. Pas shfuqizimit të nenit 11 nga Gjykata Kushtetuese, neni 10 i ligjit, i ndryshuar në vitin 2000, parashikonte se deri në zgjidhjen e problemit të strehimit, qytetarët e pastrehë, të cilët jetonin në banesat që u përkisnin ish-pronarëve, do të paguanin qiranë, sipas normave që paguanin në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit të pronës 1993.

32. Kontributi në Ligjin për Familjet e Pastreha u shfuqizua me hyrjen në fuqi të ligjit për programet sociale në vitin 2004 (shih paragrafin 37 më poshtë).

a) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 250, i datës 16 prill 1996, për procedurat dhe prioritetet në lidhje me zbatimin e kontributit në ligjin për familjet e pastreha, i ndryshuar (VKM-ja nr. 250/1996)

33. Familjet që jetonin në banesat private, të cilat u përkisnin ish-pronarëve ishin kategoria e parë e familjeve të pastreha, të cilat do të përfitonin nga dieta e strehimit e parashikuar në ligjin për familjet e pastreha, problemi i strehimit i të cilave do të trajtohej me prioritet, sipas përcaktimit në nenin 6. Neni 2.1 i vendimit parashikonte se si rezultat i zbatimit të ligjit për pronën 1993, marrëveshjet e mëparshme të qiradhënies të lidhura midis qiramarrësve dhe ish-pronarëve dhe shtetit në atë moment gjykoheshin si të lidhura midis qiramarrësve dhe ish-pronarëve në mbështetje të dokumentacionit që do të parashtrohej nga këta të fundit. Autoritetet e qeverisë lokale do të hartonin një listë me këto familje.

34. Neni 14 parashikonte se marrëveshjet ekzistuese të qiramarrjes midis qiramarrësve dhe ish-pronarëve do të rinovoheshin me anë të ndihmës së autoriteteve të qeverisë lokale. Këto marrëveshje do të kishin një afat kohor, i cili zgjaste derisa qiramarrësi do të kishte përdorur plotësisht subvencionin e dhënë prej Shtetit. Sipas nenit 15, qiramarrësit që jetonin në banesat, të cilat u përkisnin ish-pronarëve, të cilat ishin brenda normave të strehimit do të duhej të paguanin tre të

pestat e qirasë, ndërsa Shteti do të paguante pjesën e mbetur.

b) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 5/1997

35. Sipas një kërkese për shqyrtim kushtetues të ligjit për familjet e pastreha, paraqitur në Gjykatën Kushtetuese nga Shoqata e Qiramarrësve të Banesave Shtetërore, të cilat ishin ish-pronë private, më 27 shkurt 1997, Gjykata Kushtetuese vendosi të shfuqizonte nenin 11 të këtij ligji. Pasi shqyrtoi kërkesën e parashikuar në VKM nr. 250/1996, qiramarrësit do të duhej t'u paguanin ish-pronarëve tre të pestat e vlerës së qirasë, Gjykata Kushtetuese konstatoi se raporti i qirasë së pagueshme nga qiramarrësit do të ishte pothuajse ekuivalenti i një pensioni pleqërie. Për sa i përket faktit se shumica e qiramarrësve të cilët jetonin në banesa që u përkisnin ish-pronarëve kishin dalë në pension dhe përfitonin nga pensioni i vjetërsisë ose merrnin ndihmë financiare, gjykata kishte parashikuar se ata do të ishin të detyruar të përdornin të gjithë pensionin ose ndihmën financiare kundrejt pagesës së qirasë, duke e klasifikuar dhënien e saj pa asnjë qëllim dhe strehimin e tyre të pambrojtur. Rrjedhimisht, do të ishte jopraktike të zbatohej ligji në fjalë, i cili do të kishte ndikim negativ mbi interesat e qiramarrësve dhe ish-pronarëve.

36. Gjykata Kushtetuese udhëzoi miratimin e një dispozite të re, e cila do të rregullonte detyrimin e qiramarrësve, të cilët zinin ish-banesat private në mënyrë që ata t'i paguanin qiranë ish-pronarëve brenda kapacitetit të tyre financiar, deri në zgjidhjen e problemit të strehimit. Në vijim, Gjykata Kushtetuese rekomandonte se një parashikim i ri do të parashikonte indeksimin e kuotës së strehimit ndaj ndryshimit të çmimeve.

3. Programet sociale për strehimin e banorëve të ligjit për zonat urbane (ligji për programet sociale – ligji nr. 9232, i datës 13 maj 2004, i ndryshuar)

37. Ligji për programet sociale, i cili në vitin 2004 shfuqizoi ligjin për familjet e pastreha dhe në vitin 2007, ligjin e privatizimit synonte të parashikonte mundësitë për strehim të përballueshëm dhe të përshtatshëm, duke pasur në vëmendje kapacitetin financiar të familjeve, të cilat kishin nevojë për strehim. Ligji në fjalë parashikonte tre tipa programesh strehimi social: i. programet për garantimin e strehimit social me qira; ii. programet për parashikimin e strehimit me kosto të ulët; iii. programet për pajisjen e truallit me infrastrukturë (neni 3). Familjet të cilat nuk kishin përfituar nga zbatimi i ligjit të privatizimit, në rastin kur përmbushnin kërkesat e parashikuara në ligjin e programeve sociale, do të trajtoheshin me prioritet në përputhje me nenin 5.

38. Ligji për programet sociale u shfuqizua me hyrjen në fuqi të ligjit për strehimin social, në nëntor 2018.

B. Kuadri ligjor i brendshëm në lidhje me kthimin dhe kompensimin e pronës

1. Kushtetuta

39. Neni 41 i Kushtetutës, e cila hyri në fuqi në vitin 1998, parashikon se e drejta ndaj pronës private mbrohet me ligj. Ligji mund të parashikojë shpronësimin ose kufizimet në ushtrimin e një të drejtë ndaj pronës vetëm në interesin publik.

40. Neni 131 (f) i Kushtetutës parashikonte në periudhën në fjalë se Gjykata Kushtetuese do të dëgjonte ankesat përfundimtare nga individët që pretendonin një shkelje të së drejtës së tyre kushtetuese për një seancë të drejtë dëgjimore, pasi të jenë shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e asaj të drejte.

2. Ligji për pronën

a) Ligji për pronën 1993 (ligji nr. 7698, i datës 15 prill 1993, i ndryshuar)

41. Sipas ligjit për pronën 1993, ish-pronarët ose trashëgimtarët e tyre të ligjshëm kishin të drejtën të pretendonin pronësinë e tyre ndaj pronës fillestare të paluajtshme, e cila ishte shpronësuar, shtetëzuar ose konfiskuar nga regjimi komunist. Sipas përcaktimit për pronësinë, ata kishin të drejtën ose t'iu rikthehej prona e tyre fillestare e paluajtshme ose t'u jepej kompensim në vend të njërës prej formave të parashikuara në ligj. Megjithatë, sipas ligjit për pronën, vendimi i autoriteteve për t'i kthyer pronën ish-pronarëve nuk ndikonte marrëveshjet paraprake ekzistuese të qiramarrjes, të cilat u jepnin të drejtë qiramarrësve të vijonin t'i mbanin të zëna ato prona.

42. Parashikimi përkatës i ligjit për pronën 1993, siç u referua në vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 9 korrik 2005, në paragrafin 19 më sipër, parashikon si më poshtë:

Neni 14

"Marrëdhëniet midis qiramarrësve dhe ish-pronarëve që bëhen pronarë sipas këtij ligji rregullohen me [ligjin për privatizimin].

Në qoftë se ... ish-pronari i siguron qiramarrësit banesë tjetër brenda së njëjtës qendër [të pushtetit lokal] të banuar, me sipërfaqe banimi aq sa u takon sipas normave të strehimit në momentin e daljes së këtij ligji, por jo më tepër se sa ka, atëherë qiramarrësi është i detyruar të lirojë banesën.

Shteti detyrohet të zgjidhë, në përputhje me normat aktuale të strehimit, strehimin e qiramarrësve të sotëm, duke u dhënë përparësi familjeve me të ardhura të pakta financiare.

Me dëshirën e ish-pronarëve, ata mund të kompensohen sipas mënyrave të përcaktuara në këtë [ligj]."

b) Ligji për pronën 2004 (ligji nr. 9235, i datës 29 korrik 2004, i ndryshuar)

43. Për sa ka të bëjë me çështjen, ligji për pronën 2004, që shfuqizon ligjin për pronën 1993, dhe që ka hyrë në fuqi më 15 shtator 2004, parashikonte:

Neni 9

"Pronat të cilat janë pronë e ish-pronarëve do të lirohen nga qiramarrësi/t brenda tre vjetësh. Qiramarrësit do të vijojnë të paguajnë qiranë e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për dy vite pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Këshilli i Ministrave është përgjegjës për strehimin e qiramarrësve të pastrehë, duke u garantuar një banesë me qira të ulët, ose duke garantuar një banesë qiraja e së cilës mbulohet nga Shteti."

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 26/2005

44. Sipas një kërkese për shqyrtim kushtetues të nenit 9 (1) të ligjit në fjalë, paraqitur në Gjykatën Kushtetuese nga Shoqata e Qiramarrësve të Banesave Shtetërore, të cilat më herët kishin qenë prona private, më 2 nëntor 2005, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi atë dispozitë si jokushtetues. Gjykata i vuri rëndësi faktit se dispozita kishte përkeqësuar statusin e qiramarrësve krahasuar me parashikimet që kishin ekzistuar përpara hyrjes në fuqi të ligjit për pronat 2004. Ajo konstatoi se ndryshimi në legjislacion nuk respektonte parimin e sigurisë ligjore. Ajo arriti në përfundimin se një kufizim mbi të drejtën e qiramarrësve ndaj strehimit nuk mund të justifikohej nga interesi publik, duke përkrahur të drejtat ndaj pronës së ish-pronarëve. Vendimi, për sa ka lidhje me çështjen, parashikon si më poshtë:

"Deri në hyrjen në fuqi të parashikimit të mësipërm, qiramarrësve të banesave shtetërore, të cilat ishin ish-prona private, u jepeshin disa të drejta... veçanërisht: një qira fikse në nivelet e vitit 1993, derisa të gjendej një zgjidhje për problemi e strehimit; një dispozitë për strehim nga Shteti me anë të Agjencisë Shtetërore Kombëtare të Strehimit, në përputhje me kriteret e parashikuara në [Ligjin e Privatizimit 1992]. Në mbështetje të këtyre parashikimeve, Shteti, fillimisht, ndërmori të garantonte strehim me anë të privatizimit, në përputhje me kriteret të cilat përdoreshin për privatizimin e strehimit në vitin 1992, dhe së dyti, garantonte se qiratë do të mbeteshin të pandryshuara deri në zgjidhjen e problemit të [strehimit].

Neni 9(1) [i ligjit për pronën 2004] bën ndryshime të rëndësishme në të drejtat e qiramarrësve. Sipas parashikimeve të mëparshme, Shteti ndërmori të zgjidhte problemin e strehimit duke u bërë të mundur qiramarrësve të bëheshin pronarë në bazë të kritereve, të cilat zbatoheshin për pjesën tjetër të popullsisë, megjithatë dispozita e kundërshtuar nuk e vendos atë detyrim shprehimisht ndaj Shtetit. Neni parashikon garantimin e strehimit me anë të banesave me qira të ulët, huat me interes të ulët ose [pagesën e] qirave... nga Shteti.

Për më tepër, në kontrast me dispozitën e mëparshme, e cila "ngrinte" qiratë deri sa të gjendej zgjidhja e problemit të strehimit, parashikimi i kundërshtuar parashikon shprehimisht pagesën e këtyre qirave "të ngrira" për dy vitet e parë pas hyrjes në fuqi të ligjit, duke lënë të kuptohet se qiratë do të ishin të liberalizuara në përfundimin e atij afati kohor.

Ligji i ri përmban parashikime të tjera, të cilat përkeqësojnë seriozisht statusin e qiramarrësve. Ligji i mëparshëm parashikonte se banesat do të liroheshin kur qiramarrësve të tyre do t'iu garantohej strehim i përhershëm, megjithatë dispozita e kundërshtuar në mënyrë arbitrare dhe pa dhënë ndonjë siguri të shprehur, parashikon se qiramarrësit duhet të lirojnë banesat brenda tre vjetëve.

Është e qartë se neni 9 (1) [i ligjit për pronën 2004] cenon ndjeshëm disa të drejta që qiramarrësit kishin kërkuar sipas legjislacionit të mëparshëm ...

Gjykata Kushtetuese vëren, gjithashtu, se neni 9 (1) shkel ... parimin e sigurisë ligjore ...

Siguria ligjore prezumon *inter alia*, se qytetarët duhet të kenë besim te Shteti dhe në

pandryshueshmërinë e ligjit. Ai besim lidhet me faktin se qytetarët nuk duhet të shqetësohen vazhdimisht për natyrën vazhdimisht të ndryshueshme dhe pasojat e normave ligjore, të cilat cenojnë dhe përkeqësojnë statusin e përcaktuar më herët.

... Ky parim [i sigurisë ligjore] nuk mund të mbizotërojë në çdo shkallë. Kështu, nëse ndodh që rregullimi i ligjshëm i marrëdhënies ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga interesi publik, është ky i fundit që mbizotëron mbi parimin e sigurisë ligjore.

Në çështjen në fjalë, ndryshimi në ligjin në favor të një pjesë të caktuar të popullsisë nuk mund të justifikohet nga një interes publik thelbësor. Është e vërtetë se dispozita e ndryshuar favorizon pronarët e pronave; megjithatë, nga ana tjetër, ai diskriminon një grup tjetër (edhe pse i vogël në numër), duke cenuar të drejtën bazë për të jetuar të qiramarrësve dhe dispozitën për strehimin. Duke iu mohuar qiramarrësve të drejtat e tyre për t'u bërë pronarë dhe duke i dhënë fund qiramarrjes së tyre pa u garantuar një banesë tjetër nuk mund të justifikohet për asnjë arsye të interesit publik."

c) Ligji për pronën 2006

45. Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 26/2005, i vitit 2006, neni 9 i ligjit të vitit 2004, u ndryshua me përmbajtjen si më poshtë:

Neni 9

"1. Pronat të cilat janë pronë e ish-pronarëve dhe të cilat iu dhanë me qira qiramarrësve nga Shteti, përpara hyrjes në fuqi të [ligjit për privatizimet 1992], të cilat u përdorën për nevoja strehimi, do t'u transferohen në pronësi ish-pronarit/ëve, kur përmbushet një prej kushteve si më poshtë:

a) nevojat për strehim të qiramarrësve janë përmbushur në çdo mënyrë tjetër të ligjshme;

b) ish-pronari i garanton qiramarrësit një banesë e cila ka një sipërfaqe jo më të vogël se sa banesa në të cilën ata tashmë zënë, dhe e cila është afërsisht në kushte të ngjashme dhe brenda së njëjtës qeverisje lokale, deri sa të vijë momenti që nevojat për strehim të qiramarrësve të përmbushen në një nga mënyrat e tjera të parashikuara në këtë seksion;

c) qiramarrësit përmbyllin një marrëveshje huaje me një institucion financiar, në përputhje me... [ligjin për programet sociale 2004];

d) qiramarrësit përfitojnë strehim ose një sipërfaqe toke sipas parashikimit në ... [ligjin për programet sociale 2004]"

...

4. Të pastrehët të cilët janë qiramarrës në banesa që janë pronë e ish-pronarëve dhe të cilët nuk kanë lidhur një marrëveshje huaje sipas nënparagrafit "c" të paragrafit të parë të këtij seksioni, ose nuk iu është ofruar ende strehim, sipas nënparagrafëve "a", "c" dhe "d" të paragrafit të parë të këtij neni, humbasin të drejtën e tyre për të zënë ligjërisht banesën deri më 31 dhjetor 2008. Atyre do t'iu ofrohen programe të posaçme strehimi, në përputhje me nenin 4 të ligjit për programet sociale. Ish-pronari do të ketë të drejtën të marrë në zotërim banesën nën pronësinë e tij.

5. Qiraja për banesat e zëna nga të pastrehët, sipas parashikimit në paragrafin 1 të këtij seksioni do të indeksohet ... në çmimin vjetor dhe në rritjet e pagave, dhe qëllimi i saj është mbulimi i shpenzimeve të pronarit për mirëmbajtjen dhe miradministrimin e banesës ..."

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 11/2007

46. Në vijim të një kërkese për shqyrtim kushtetues të nenit të ndryshuar 9, me arsyen se ai shkelte parimin e të drejtave të fituara dhe gjetjet e Gjykatës Kushtetuese në vendimin e saj nr. 26/2005, paraqitur në Gjykatën Kushtetuese nga Shoqata e Qiramarrësve të Banesave Shtetërore, të cilat më herët ishin prona private, më 4 prill 2007, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi nenin e ndryshuar për të njëjtat arsye të parashikuara në vendimin e saj nr. 26/2005. Ajo urdhëronte miratimin e dispozitave të reja për të mbushur vakumin ligjor.

d) Akti normativ 2012

47. Më 1 gusht 2012, Qeveria paraqiti një akt normativ për lirimin e pronave të ish-pronarëve, të cilat vijonin të ishin të zëna nga qiramarrësit. Në vijim, akti normativ u miratua nga parlamenti, më 13 shtator 2012.

48. Afati për të liruar vullnetarisht pronat e ish-pronarëve u vendos data 1 nëntor 2012. Në rastin e një pamundësie për të liruar një pronë vullnetarisht brenda afatit të parashikuar kohor, AKS-ja me anë të një njoftimi me shkrim të ish-pronarit, do të lëshonte një urdhër dëbimi, i cili do të konsiderohej një vendim i ekzekutueshëm sipas kuptimit të Kodit të Procedurës Civile. Më pas, AKS-ja do t'i kërkonte Gjykatës së Rrethit të lëshonte një urdhër ekzekutimi të përmbarimit për lirimin e

apartamentit. Neni 3 pengon ndalimin e ekzekutimit të urdhrit të përmbarimit.

49. Detajet e aktit normativ, duke përfshirë procedurat e pasuksesshme për shqyrtim kushtetues, paraqitur përpara Gjykatës Kushtetuese kundër tij, përshkruhen në vendimin e Gjykatës në çështjen *Bakiu dhe të Tjerët kundër Shqipërisë* (vendim) nr. 43928/13 dhe 16 kërkesa të tjera, 10 prill 2018.

C. Praktikë tjetër gjyqësore e brendshme relevante

50. Në vendimet nr. 36/2002 dhe nr. 531/2002, Gjykata e Lartë pushoi paditë civile të pronarëve në lidhje me pagesën e qirave të tregut të lirë (të liberalizuara) nga qiramarrësit, duke zënë banesa, të cilat u ishin kthyer pronarëve, në cilësinë e tyre si ish-pronarë dhe i ridërgoi çështjet për shqyrtim përpara Gjykatës së Apelit. Gjykata e Lartë arsyetonte se neni 11 i ligjit për familjet e pastreha ishte shfuqizuar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 5/1997. Në vijim, ajo pohoi se neni 10, ndryshuar në vitin 2000, parashikonte se qiramarrësit duhej të paguanin një qira në bazë të normave në të cilat kishin paguar në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit për pronën 1993 (shih edhe paragrafin 31 më sipër).

51. Në vendimin nr. 44, të datës 24 shkurt 2009, Gjykata e Lartë, në mbështetje të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nr. 26/2005 dhe nr. 11/2007, rrëzoi pretendimin e pronarit për lirimin e pronës së zënë nga qiramarrësit, për aq sa problemi i qiramarrësve për strehim nuk ishte zgjidhur nga autoritetet. Për pasojë, Gjykata e Lartë e kundërshtoi pretendimin për pagesë të një qiraje të tregut të lirë nga qiramarrësit.

LIGJI

I. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS

52. Kërkuesi u ankua se ishte shkelur neni 1, i protokollit nr. 1 të Konventës, në lidhje me pamundësinë e tij të rifitonte pronësinë e shtëpisë së tij dhe të merrte të ardhura prej saj.

Neni 1 i protokollit nr. 1 parashikon si më poshtë:

"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive, në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera."

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

53. Qeveria parashtroi se kërkuesi nuk kishte shfrytëzuar mjetet e brendshme, më konkretisht një ankesë në Gjykatën Kushtetuese, sipas nenit 131 të Kushtetutës së Shqipërisë për një shkelje të pretenduar të të drejtave të tij. Gjithashtu, Qeveria parashtroi se ankuesi nuk kishte paraqitur një padi administrative ose nuk kishte dorëzuar një padi civile ndaj aktit administrativ, i cili i kishte dhënë statusin e të pastrehuarit qiramarrësve që jetonin në pronën e tij.

54. Kërkuesi, në mbështetje të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nr. 5/1997, 26/2005 dhe 11/2007, parashtroi se një ankesë kushtetuese do të kishte qenë joefikase, përderisa ajo gjykatë nuk kishte mbrojtur të drejtat e ish-pronarëve.

2. Vlerësimi i Gjykatës

55. Gjykata kujton se të vetmet mjete të cilat kërkohen të shterohen nga neni 35 § 1 i Konventës janë ato që lidhen me shkeljen e pretenduar dhe mund të kompensojnë shkeljen e pretenduar. Ekzistenca e këtyre mjeteve duhet të jetë mjaftueshëm e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, mosrealizimi i të cilave do të pengojë aksesueshmërinë e nevojshme dhe efikasitetin: i takon Shtetit përgjegjës të përcaktojë nëse këto kushte janë përmbushur (shih, së fundmi, *Magyar Kétfarkú Kutya Párt kundër Hungarisë* [DHM] nr. 201/17, § 52, 20 janar 2020).

56. Gjykata vëren se sipas nenit 131 (f) të Kushtetutës në periudhën në fjalë, Gjykata Kushtetuese ishte kompetente për shqyrtimin e shkeljeve të pretenduara të së drejtës për një seancë të drejtë dëgjimore, garantuar nga neni 6 i Konventës, për të drejtat kushtetuese të kërkuesit. Ky mjet ishte i jashtëzakonshëm, duke qenë se Gjykata Kushtetuese do të duhej të shqyrtonte procedimet në tërësi, që nga procedimet përpara gjykatës së shkallës së parë, te procedimet përpara Gjykatës së Lartë, për aq sa ato lidheshin me një shkelje të pretenduar të së drejtës për një seancë të drejtë dëgjimore, të drejtë të mbrojtur nga neni 6 i Konventës (shih *Jakupi kundër Shqipërisë* (vendim)

nr. 11186/03, 1 dhjetor 2009, dhe *Balliu kundër Shqipërisë* (vendim) nr. 74727/01, 30 shtator 2004).

57. Duke u kthyer te çështja konkrete, Gjykata vëren se kërkuesi nuk pohoi në asnjë pikë të procedimeve përpara kësaj Gjykatë se i ishin shkelur të drejtat sipas nenit 6 të Konventës. Në fakt, e vetmja ankesë e tij, në bazë të së cilës u njoftua Qeveria e paditur për çështjen, kishte të bënte me një shkelje të gëzimit të qetë të pronës së tij, garantuar nga neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës. Në këto rrethana, Gjykatë vlerëson se për qëllime të nenit 35 § 1 të Konventës, apelimi kushtetues në periudhën konkrete nuk do të ishte një mjet, i cili do të mund të kishte qenë efikas në praktikë për ankesën aktuale. Për këtë arsye, kërkuesit nuk iu kërkua që ta shfrytëzonte atë mjet dhe për pasojë Gjykata vendos të rrëzojë këtë kundërshtim.

58. Gjithashtu, Gjykata vëren se ankuesi ndërmori procedime ligjore përpara gjykatave vendëse, në mënyrë që qiramarrësit të lironin pronën e tij. Në vendimin e saj përfundimtar, Gjykata vlerëson, se ndryshe nga kundërshtimi i Qeverisë, do të kishte qenë e pavlerë që kërkuesi në ndërmerrte procedime të veçanta për të kundërshtuar statusin e të pastrehut të qiramarrësve. Për këtë arsye, Gjykata e rrëzon këtë kundërshtim.

59. Gjykata konstaton se kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në fakte, sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Duke mos qenë e papranueshme në secilin argument tjetër, atëherë ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

a) Kërkuesi

60. Kërkuesi parashtroi se ai ishte privuar nga zotërimi i pronës së tij dhe nga përdorimi i të ardhurave në treg. Shteti nuk i kishte garantuar mirëmbajtjen e pronës, gjë e cila do të kërkonte kosto shtesë, për ta kthyer atë në gjendje të mirë. Kërkuesi argumentoi se paragrafi i parë i nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës aplikohej në çështjen në fjalë.

61. Kërkuesi parashtroi se asnjë autoritet ose gjykatë e brendshme nuk e kishte përshkruar ndonjëherë ndërhyrjen e bërë në interesin publik. Një interes i tillë nuk kishte ekzistuar as kur numri i qiramarrësve ishte shumë më i vogël sesa numri i ish-pronarëve. Për shembull, në Tiranë gjendeshin më pak se 960 familje që jetonin në banesat e ish-pronarëve. Në vijim, ai parashtroi se ndërhyrja kishte vijuar për 19 vjet (nga viti 1990 deri në vitin 2009) dhe në këtë mënyrë situata nuk mund të konsiderohej më tej e jashtëzakonshme.

62. Për sa i përket testit të proporcionalitetit, kërkuesi parashtroi se ish-pronarët nuk kishin gëzuar ende plotësisht të drejtat e tyre për pronën, gjatë gjithë asaj kohe. Nuk ishte vendosur asnjë balancë midis interesave konkurrues; Shteti kishte favorizuar qiramarrësit në dëm të të drejtave të ish-pronarëve. Megjithatë, në situatën e tij, dëbimi i qiramarrësve nuk do të kishte rezultuar në ndonjë pasojë të rëndë ose prishje të rendit publik, duke qenë se B.S. dhe M.S. jetonin jashtë vendit, dhe J.D. jetonte vetëm.

63. Kërkuesi parashtroi se ish-pronarëve u ishte paguar një qira e ulët mujore, e barasvlershme me qiranë që kishte ekzistuar përpara vitit 1990, më konkretisht dy euro në muaj, ndërsa qiraja mujore e tregut të lirë faktikisht ishte shumë më e lartë. Së bashku me motrat dhe vëllezërit e tij, ai do të kishte fituar 2,160 euro në muaj duke e dhënë shtëpinë me qira.

64. Autoritetet nuk kishin marrë masa për të garantuar strehimin e qiramarrësve në përputhje me ligjin për familjet e pastreha dhe legjislacionin dytësor, i cili i klasifikonte ata si kategori prioritare (shih paragrafin 33 më sipër). Në të kundërt, gjatë viteve, autoritetet i kishin garantuar strehim kategorive të tjera të familjeve të pastreha. Me hyrjen në fuqi të ligjit për programet sociale, qiramarrësit që jetonin në banesat e ish-pronarëve nuk pozicionoheshin më në një kategori prioritare, ndërsa kategoria e familjeve që kualifikoheshin në programet për strehim social ishte rritur. Gjithashtu, ai parashtroi se Gjykata Kushtetuese, me anë të vendimeve të saj nr. 26/05 dhe 11/07, kishte rrëzuar parashikimet e Ligjit për Pronën, i cili parashikonte një zgjidhje për problemin. Që prej asaj kohe, dhe deri në datën kur kërkuesi parashtroi vërejtjet e tij, më 4 shtator 2009, autoritetet nuk kishin ofruar ndonjë mjet tjetër. Gjithashtu, ai parashtroi se ish-pronarët kishin pasur një barrë të shpërpjesëtuar për një periudhë të gjatë, pa shpresë për zgjidhje. Nuk ekzistonte asnjë akt ligjor apo garanci procedurale që zgjidhte problemin me të cilin përballeshin ata.

b) Qeveria

65. Qeveria parashtroi se për këtë çështje do të parashtrohej paragrafi i dytë i nenit 1 i protokollit

nr. 1 i Konventës. Ata pranonin se kishte pasur një ndërhyrje me të drejtën e kërkuesit për pronë. Megjithatë, ndërhyrja ishte parashikuar nga ligji dhe kishte ndjekur edhe një qëllim legjitim, më konkretisht, mbrojtjen e të drejtave të qiramarrësve për strehim. Në vijim, Qeveria parashtroi se ndërhyrja kishte filluar nën regjimin komunist dhe kishte lidhje me procesin e tranzicionit në vend.

66. Për sa i përket testit të proporcionalitetit, Qeveria parashtroi se ndërhyrja ishte bërë në kontekstin e politikave që synonin drejtësi sociale për individët dhe familjet, të cilët kishin nevojë për mbrojtjen e së drejtës së tyre për jetë familjare dhe së drejtës së tyre për një shtëpi. Situata mund të klasifikohej si e jashtëzakonshme. Më konkretisht, procedimet për dëbimin e qiramarrësve do të shoqëroheshin me pasoja të rënda për rendin publik, duke ndikuar në këtë mënyrë qindra familje. Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimeve administrative që njihnin të drejtat ndaj tokës së ish-pronarëve do të kishte prekur nivelet minimale të jetesës së gëzuar nga qiramarrësit, ndërsa ish-pronarët nga ana tjetër, përfitonin disa të ardhura nga pagesa e qirasë. Shteti kishte autoritetin të ndërhynte në problemin e strehimit, i cili nuk mund t'i lihej plotësisht logjikës së tregut. Në vlerësimin e interesave konkurrues midis të drejtave të ish-pronarëve dhe nevojave për strehim të qiramarrësve, Palëve Shtetërore u lihej një margjinë vlerësimi për përzgjedhjen e mjeteve të nevojshme për të arritur atë qëllim. Në vijim ato parashtronin se Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj kishte vendosur në favor të qiramarrësve, duke pasur në konsideratë parimin e sigurisë ligjore.

67. Në vijim, Qeveria parashtronte se Shteti shqiptar ishte përpjekur disa herë të gjente një zgjidhje për problemin, por kompleksiteti i situatës dhe fakti se disa masa ishin rrëzuar nga Gjykata Kushtetuese nënkuptonte se ata nuk e kishin gjetur një të tillë. Megjithatë, autoritetet e brendshme kishin marrë dhe ende po merrnin masa procedurale dhe institucionale për të zgjidhur problemet e strehimit të qiramarrësve. Për shembull, autoritetet lokale ishin përgjegjëse për ndërtimin e strehimit për t'iu siguruar atyre streha. Procesi i ndërtimit kërkonte një kohë të caktuar për shkak të numrit të madh të familjeve të përfshira, konkretisht 5,000. Megjithatë, ato po merrnin masat për të zgjidhur problemin sa më shpejt të ishte e mundur.

68. Duke u kthyer në çështjen në fjalë, Qeveria parashtroi se kërkuesi nuk kishte nevojë për strehim. Prona e tij i ishte dhënë me qira personave, të cilët kishin statusin e të pastrehut. Ata kishin paguar qiranë, e cila ishte kontrolluar nga Shteti dhe e cila nuk ishte hequr ende. Për këtë arsye, nuk mund të thuhej se ndërhyrja përbënte një barrë serioze për kërkuesin dhe ish-pronarët e tjerë, sepse ishte e një natyre të përkohshme.

2. Vlerësimi i Gjykatës

69. Gjykata vëren se, e drejta e babait të kërkuesit për kthimin e pronës së tij u njoh më 27 shtator 1995, megjithatë periudha e shqyrtimit nga Gjykata filloi më 2 tetor 1996 – datë në të cilën Konventa hyri në fuqi për Shqipërinë – dhe përfundoi kur kërkuesi rifitoi zotërimin e pronës në vitin 2010 (shih paragrafin 20 më sipër).

a) Nëse kishte një ndërhyrje në gëzimin e qetë të kërkuesit të "zotërimeve" të tij

70. Gjykata e konsideron se është e nevojshme të përcaktohet ndërhyrja e pretenduar në çështjen konkrete, ekzistenca e së cilës nuk është kundërshtuar nga palët. Në lidhje me këtë, neni 1 i protokollit nr. 1 përmban tre rregulla të qartë: rregulla e parë i parashtruar në fjalinë e parë të paragrafit të parë është i një natyre të përgjithshme dhe parashtron parimin e gëzimit të qetë të pronës; rregullia ie dytë e cila gjendet në fjalinë e dytë të paragrafit të parë mbulon privimin e zotërimeve dhe e bën atë objekt të një sërë kushtesh; rregulla e tretë ei parashtruar në paragrafin e dytë njeh të drejtën e Shteteve Kontraktuese *inter alia* të kontrollojnë përdorimin e pronës, në lidhje me interesin e përgjithshëm. Të tria rregullat kanë të bëjnë me shkallë të caktuara të ndërhyrjes me të drejtën për gëzim të paqtë të pronës dhe për këtë arsye duhet të interpretohen në dritën e parimit të përgjithshëm të përcaktuar në rregullën e parë (shih, midis autoriteteve të tjerë, *G.I.E.M. S.R.L. dhe të Tjerët kundër Italisë* [DHM] nr. 1828/06 dhe 2 të tjerë, § 289, 28 qershor 2018).

71. Duke u rikthyer në çështjen konkrete, argumenti kryesor i kërkuesit është se ai nuk kishte mundësi të merrte zotërimin e pronës së tij, për faktin se ajo ishte e zënë nga qiramarrësit. Në procedimet e brendshme në lidhje me dëbimin e qiramarrësve, gjykatat e brendshme konstatuan se situata kishte qenë rezultat i veprimit të legjislacionit të brendshëm. Gjykata nuk konstaton asnjë arsye për të justifikuar nxjerrjen e një

konkluzioni tjetër. Ajo vëren se zbatimi kumulativ i statuteve të brendshëm, më konkretisht ligji për privatizimin, kontributi në ligjin për familjet e pastreha dhe ligji për pronën, parashikonin të drejtën e qiramarrësit për të vijuar të mbante të zëna banesat private të cilat u ishin kthyer ish-pronarëve, si kërkuesit në çështjen konkrete.

72. Në vijim, Gjykata konstaton se ndërhyrja nuk përbënte as shpronësimin formal dhe as atë *de facto*. Pronësia e kërkuesit ndaj pronës ishte regjistruar në regjistrin e pronës (shih paragrafin 13 më sipër) dhe ai nuk e humbi kurrë atë pronësi apo të drejtën e tij për ta shitur pronën e tij. As autoritetet nuk ushtruan masa që rezultonin në transferimin e kësaj pronësie. Ndërhyrja, në këtë mënyrë, synonte bërjen objekt të pronës së tij ndaj një qiramarrje të vazhduar dhe jo ta merrnin atë prej tij në mënyrë të përhershme. Sipas rastit, Gjykata mendon se ndërhyrja në fjalë përbënte një masë e cila parashikonte kontrollin e përdorimit të pronës, sipas kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

b) Nëse ndërhyrja ishte e justifikuar

i. Nëse ndërhyrja "parashikohej në ligj"

73. Kërkesa e parë dhe më e rëndësishme e nenit 1 të protokollit nr. 1 është se çdo ndërhyrje për gëzimin e paqtë të zotërimeve duhet të jetë e ligjshme. Veçanërisht, paragrafi i dytë i nenit 1 parashikon se Shtetet kanë të drejtën të kontrollojnë përdorimin e pronës, ndërsa subjektet të drejtën e tyre me kushtin që ky kontroll të ushtrohet duke venë në zbatim "ligjet". Për më tepër, parimi i ligjshmërisë presupozon se parashikimet e zbatueshme të ligjit të brendshëm janë mjaftueshëm të aksesueshme, precize dhe të parashikueshme në zbatimin e tyre (shih, për shembull, *Ghigo kundër Maltës* nr. 31122/05, § 51, 26 shtator 2006). Me qëllim shqyrtimin e ligjshmërisë, Gjykata përsërit se kryesisht u takon autoriteteve të brendshme, veçanërisht gjykatave, që të interpretojnë dhe të zbatojnë ligjin e brendshëm dhe të vendosin për çështjet e kushtetutshmërisë (shih, për shembull, *R&L, s.r.o. dhe të Tjerët kundër Republikës së Çekisë* nr. 37926/05 dhe 4 të tjerë, § 115, 3 korrik 2014).

74. Fakti se ndërhyrja ishte e ligjshme ishte një çështje e padiskutuar nga palët. Siç shprehet në paragrafin 71 më sipër, Gjykata konsideron se baza ligjore për ndërhyrjen shtrihet në statutet e brendshme, të cilët ishin në fuqi në periudhën konkrete. Nuk ka asnjë tregues se parashikimet përkatëse të atyre statuteve, të interpretuar sipas gjykatave ë brendshme, nuk përmbushnin kërkesat për aksesueshmëri të mjaftueshme, precizion dhe parashikueshmëri, pavarësisht ndryshimeve të vazhdueshme të legjislacionit. Për këtë arsye, ndërhyrja parashikohej nga ligji, sipas parashikimit të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

ii. Nëse ndërhyrja ndoqi një qëllim legjitim

75. Çdo ndërhyrje me qëllim kontrollin e përdorimit të pronës mund të justifikohet vetëm nëse vërtetohet të jetë *inter alia*, "në përputhje me interesin e përgjithshëm". Për shkak të dijenisë së tyre të përgjithshme të shoqërisë së tyre dhe të nevojave të saj, autoritetet e brendshme në parim janë më mirë të pozicionuara se sa gjyqtari ndërkombëtar në vlerësimin se çfarë është në interesin "e përgjithshëm" të "publikut". Nocioni interesi "i përgjithshëm" i "publikut" domosdoshmërisht është i gjerë. Veçanërisht, sfera të tilla si strehimi i popullsisë, të cilat shoqëritë moderne e konsiderojnë si nevojën kryesore sociale dhe i cili luan një rol qendror në mirëqenien dhe politikat ekonomike të Shteteve Kontraktuese, shpesh mund të kërkojë një lloj rregullimi nga Shteti. Në atë sferë, vendimet nëse dhe nëse po, ku, duhet t'i lihen plotësisht lojës së forcave të tregut të lirë ose duhet të jetë subjekt i kontrollit të Shtetit, ashtu si edhe zgjedhja e masave për të siguruar nevojat për strehim të komunitetit dhe të kohës për zbatimin e tyre, në mënyrë të domosdoshme përfshin shqyrtimin e çështjeve komplekse sociale, ekonomike dhe politike. Duke e konsideruar si të natyrshme që margjina e vlerësimit të disponueshëm për legjislaturën në zbatimin e politikave sociale dhe ekonomike duhet të jetë e gjerë, në shumë raste, Gjykata ka deklaruar se do të respektojë vendimin e legjislaturës për atë se çfarë është në interesin "e përgjithshëm" të "publikut", vetëm në rast se ai vendim nuk është qartazi i pa themel të arsyeshëm (shih midis autoriteteve të tjerë *Hutten-Czapska kundër Polonisë* [DHM] nr. 35014/97, §§ 165–66, GJEDNJ, 2006-VIII, dhe *Amato Gauci kundër Maltës* nr. 47045/06, § 54, 15 shtator 2009).

76. Gjykata pranon se legjislacioni i brendshëm, sipas interpretimit nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 5/1997 dhe 26/2005 (shih paragrafët 35 dhe 44 më sipër) synonte të parashikonte strehim për pjesën vulnerabël të

shoqërisë, si për shembull, pensionistët, në një vend ku mundësia për të siguruar banesa nuk mund të përmbushte kërkesën. Gjithashtu, ai synonte ofrimin e akomodimit për çmime të arsyeshme dhe të përballueshme për ata anëtarë të popullatës me më pak të ardhura, të cilët nuk kishin mjetet financiare të paguanin akomodim alternativ. Gjykata është e përgatitur të pranojë se në rrethanat sociale dhe ekonomike të Shqipërisë, në periudhën konkrete, kontrolli i përdorimit të pronës së ankuesit kishte një qëllim legjitim për interesin e përgjithshëm, sipas parashikimit të paragrafit të dytë të nenit 1 të protokollit nr. 1.

iii. Nëse ndërhyrja ishte e proporcionale

77. Çdo ndërhyrje në pronë duhet të kënaqë edhe kërkesën e proporcionalitetit. Ashtu si Gjykata ka deklaruar në mënyrë të përsëritur, duhet të gjendet një balancë e drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit, përpjekja për ta gjetur këtë balancë të drejtë e cila është e qenësishme në të gjithë Konventën. Balanca e nevojshme nuk vendoset në rastin kur personi konkret mban një barrë individuale (shih, midis autoriteteve të tjerë *Brumărescu kundër Rumanisë* [DHM] nr. 28342/95, § 78, GJEDNJ, 1999-V). Shqetësimi për ta arritur këtë balancë reflektohet në strukturën e nenit 1 të protokollit nr. 1 si i tërë. Në çdo rast, me përfshirjen e një shkeljeje të pretenduar të atij neni, Gjykata për këtë arsye duhet të sigurojë, se nëse, për shkak të ndërhyrjes së Shtetit, personit në fjalë iu desh të përballonte një barrë të shpërpjestimuar dhe të madhe (shih *Bittó dhe të Tjerët kundër Slovakisë* nr. 30255/09, § 97, 28 janar 2014).

78. Në vlerësimin e respektimit të nenit 1 të protokollit nr. 1, Gjykata duhet të bëjë një kontroll të përgjithshëm të një sërë interesash në konsideratë, duke mbajtur në mendje se Konventa synon të ruajë të drejtat, të cilat janë "praktike dhe efikase". Duhet të shikojë çfarë fshihet pas anës sipërfaqësore dhe të hetojë realitetet e situatës për të cilën është bërë ankesë. Në rastet që kanë të bëjnë me veprimin e legjislacionit të gjerë për strehimin, ai vlerësim mund të përfshijë jo vetëm kushtet e dhënies me qira marrë nga pronarët individualë dhe nivelin e ndërhyrjes së Shtetit në lirinë e kontratës dhe marrëdhënieve kontraktuale në tregun e qiradhënies, por edhe praninë e masave mbrojtëse të tjera, të cilat sigurojnë se funksionimi i sistemit dhe ndikimi i tij mbi të drejtat e një pronari nuk janë as arbitrare as të paparashikueshme. Pasiguria – qoftë legjislative, administrative ose e lindur prej praktikave të zbatueshme nga autoritetet – është një faktor për t'u marrë në konsideratë në vlerësimin e reagimit të Shtetit. Në të vërtetë, në rastin kur një çështje e interesit të përgjithshëm është në rrezik, është detyra e autoriteteve publike të veprojnë në kohën e duhur dhe në mënyrën e duhur dhe konsistente (shih *Immobiliare Saffi kundër Italisë* [DHM] nr. 22774/93, § 54, GJEDNJ 1999-V).

79. Gjykata është e mendimit se shtytja kryesore e ankesës së kërkuesit përpara Gjykatës ka të bëjë me pamundësinë e tij për të rifituar zotërimin e pronës së tij, e cila ishte e zënën nga qiramarrësit sipas marrëveshjeve të qiramarrjes. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se kuadri përkatës ligjor synonte të ofronte mbrojtjen e strehimit për një kategori të kufizuar qiramarrësish, të cilët do të ndikoheshin nga kthimi i pronave tek ish-pronarët në një kontekst transitor; si i tillë, ajo nuk mori në konsideratë një sistem të përgjithshëm kontrolli qiraje në përfitim të familjeve me të ardhura të pakta (krahaso *Riedel dhe të Tjerët kundër Sllovakisë* nr. 44218/07 dhe 3 të tjerë; §§ 7 dhe 28 33, 10 janar 2017; *Hutten-Czapska*, cituar më sipër, §§ 154–225; dhe *Mellacher dhe të Tjerët kundër Austrisë*, 19 dhjetor 1989, §§ 42–47, seritë A, nr. 169). Gjithashtu, dhe më e rëndësishmja, skema, që prej fillimit, synohej të ishte për një afat të kufizuar kohe me Shtetin, i cili qartazi ushtronte përgjegjësinë për të siguruar zgjidhje alternativë për strehim për qiramarrësit e prekur gjatë kësaj periudhe tranzitore (shih paragrafët 23, 24 dhe 42 më sipër). Në vijim, Gjykata vëren se si një rregull e përgjithshme, një marrëveshje qiramarrjeje normalisht do të lidhej në mënyrë vullnetare midis palëve me qiranë, e cila reflekton nivelin e tregut në kohën kur ishte lidhur marrëveshja. Megjithatë, në rastin konkret, siç edhe parashikohet në paragrafin 33 më sipër, marrëveshjet e qiramarrjes u krijuan *ex lege* nga transferimi i marrëveshjeve të mëparshme ekzistuese të lidhura midis qiramarrësit dhe Shtetit. Kërkuesi nuk kishte ndikim në zgjedhjen e qiramarrësve ose në elementet thelbësore të marrëveshjeve të qiramarrjes. Por as nuk mund të argumentohet se kërkuesi, në mënyrë implicite, kishte hequr dorë nga e drejta e tij për të zgjedhur qiramarrësit, duke qenë se ai nuk e pati kurrë mundësinë për ta ushtruar atë të drejtë (shih *R &*

L, s.r.r., dhe të Tjerët, kundër Republikës Çeke cituar më sipër, § 106).

80. Për më tepër, duke iu referuar marrëveshjes së qirasë së lidhur midis njërit prej qiramarrësve dhe Shtetit, një kopje të së cilës e dha kërkuesi, Gjykata vëren se marrëveshja nuk ishte e kufizuar në kohë. Megjithëkëtë, kërkuesi ndërmori procedimet për dëbim ndaj qiramarrësve. Gjykata vlerëson se detyra e gjykatave të brendshme ishte e vështirë në një çështje sensitive në nivel social. Ajo vëren se Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë nuk u lejuan që të vendosnin një balancë të drejtë midis interesave në rrezik, për shkak të kufizimeve të ushtruara nga legjislacioni i brendshëm.

81. Për më tepër, Gjykata nuk është e bindur se interesat e dy qiramarrësve, konkretisht B.S. dhe M.S., të cilët kishin jetuar jashtë vendit që përpara fillimit të procedimeve gjyqësore, duhet të kishin mbizotëruar, në mbështetje të nenit 1 të protokollit nr. 1, mbi interesat e kërkuesit ndaj pronës. Më i rëndësishëm është fakti se kërkuesi nuk kishte mundësi të përftonte qira të arsyeshme, duke qenë se niveli i qirasë ishte i ngrirë në nivelin që kishte qenë në vitin 1993 (shih paragrafët 35, 31 dhe 50 në atë rend) dhe gjatë gjithë pjesës tjetër të periudhës nën vëmendjen e Gjykatës (shih paragrafin 69 më sipër). Për më tepër, legjislacioni nuk parashikonte ndonjë përshtatje të qirasë për të marrë në konsideratë ndryshimet në inflacion.

82. Pas rezultatit të pasuksesshëm të procedimeve për dëbim, kërkuesi nuk kishte ndonjë mjet tjetër për të zgjidhur marrëveshjet. Kjo e bënte të pamundur që ai rifitonte zotërimin e pronës së tij, duke e lënë në dorë të qiramarrësve të zgjidhnin marrëveshjet e qiramarrjes. Një rrugë e tillë ishte një mundësi disi e largët në rrethanat e rastit konkret, pikërisht për shkak të pagesës së një qiraje fikse, ekzistencës së një marrëveshjeje qiramarrjeje me kohëzgjatje të papërcaktuar dhe mungesës së akomodimit të përballueshëm dhe të përshtatshëm. Fakti se e drejta e pronarit për të zgjidhur marrëveshjen e qiramarrjes ishte seriozisht e kufizuar përsëritet në vijimësi në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë (shih paragrafin 51 më sipër).

83. Kjo situatë e la kërkuesin në mënyrë të pashmangshme në një gjendje pasigurie "të vazhdueshme" për faktin nëse do të mund të ishte në gjendje ndonjëherë të rifitonte pronën e tij, pikërisht për shkakun se dispozitat statutore të prezantuara në vitin 2004 dhe 2006 u shfuqizuan më pas në vitin 2005 dhe 2007 si të padrejta për qiramarrësit. Për më tepër, nuk u mor asnjë masa për të plotësuar vakumin pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese 11/2007 pavarësisht drejtimit të marrë për këtë aspekt në atë vendim (shih paragrafin 46 më sipër). Qeveria e miratoi aktin normativ 2012 për lirimin e pronave të ish-pronarëve, të cilat vijonin të ishin të zëna nga qiramarrësit (shih paragrafin 47 më sipër). Gjithashtu, nuk është provuar se autoritetet kombëtare morën masa konkrete për të ofruar strehim alternativ për qiramarrësit, të cilët kishin zënë shtëpinë e kërkuesit, gjatë gjithë periudhës në shqyrtim nga Gjykata (shih paragrafin 69 më sipër). Kuadri kombëtar ligjor, sipas interpretimit nga gjykatat vendase dhe i zbatuar nga agjencitë respektive zbatuese, efektivisht e vendosi të gjithë barrën e një situate komplekse në rend social mbi kërkuesin.

84. Së fundmi, kërkuesi nuk mund të qortohet për këtë situatë, duke qenë se ishte përtej kontrollit të tij, për arsyet e dhëna në paragrafët e mësipërm. Gjykata vëren se ai ishte i detyruar të priste për një kohë jashtëzakonisht të gjatë – më shumë se 13 vjet – përpara se të ishte në gjendje të rimerrte zotërimin e pronës së tij, gjë e cila përfundimisht nuk ishte për shkak të ndërhyrjes së autoriteteve.

85. Në mbështetje të këtyre konsideratave dhe, më specifikisht, duke marrë në konsideratë marrëveshjet e qiramarrjes të ushtruara nga ligji, mungesën e mekanizmave të përshtatshëm që ruajnë të drejtën e kërkuesit për të zgjidhur marrëveshjet e qiramarrjes, duke përfshirë mungesën e harkut kohor specifik të parashikuar nga ligji për këtë qëllim, vlerën e vogël të qirasë së përcaktuar nga ligji, e cila nuk lejonte ketë indeksim në inflacion (listën e çmimeve), periudhën e gjatë të pasigurisë në të cilën u gjend kërkuesi, Gjykata konstaton se kërkuesi është detyruar të përballojë një barrë të shpërpjestimuar dhe të madhe. Në vijim, Shteti nuk vendosi balancën e nevojshme të drejtë midis interesave të përgjithshëm të komunitetit dhe mbrojtjes të së drejtës së kërkuesit ndaj pronës.

86. Është shkelur neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës.

II. ZBATIM I NENIT 41 TË KONVENTËS

87. Neni 41 i Konventës parashikon:

"Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj

dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar."

A. Dëmi

88. Kërkuesi paraqiti një raport vlerësimi, sipas së cilit ndërtesa me tri kate u vlerësua në vlerën rreth 351,300 euro dhe humbjen e përfitimit prej dhënies me qira të godinës për pesëmbëdhjetë vite (nga viti 1994, kur prona u rikthye nga autoritetet, deri në 2009, kur kërkuesi parashtroi kërkesën e tij për shpërblim të drejtë) u përllogarit në vlerën 338,800 euro. Raporti i vlerësimit deklaronte se qiraja për metër katror në zonën përkatëse ishte 5–10 euro dhe se ai po kërkonte vlerën më të ulët, më konkretisht 5 euro për m^2. Përllogaritja u bë në bazë të një qiraje fikse (5 euro) gjatë gjithë periudhës. Kërkuesi, gjithashtu, pretendonte se kishte shpenzimet për riparimet dhe dëmtimet, e shkaktuara gjatë viteve, pa e saktësuar shumën.

89. Qeveria i kërkoi Gjykatës që të vendoste se çdo konstatim shkelje do të përbënte në vetvete dëmshpërblim të mjaftueshëm për dëmin e vuajtur nga kërkuesi. Në një alternativë tjetër, Qeveria parashtroi se pretendimi i kërkuesit ishte i paarsyeshëm dhe i pabazuar. Raporti i ekspertit nuk ishte i detajuar dhe godina kishte dy kate faktikisht.

90. Gjykata vëren se, në lidhje me shkeljen e konstatuar në çështjen konkrete, kërkuesit i jepet e drejta për dëmshpërblim. Megjithatë, Gjykata është e mendimit, se duke pasur parasysh interesin e përgjithshëm, për shkak të ndërhyrjes në të drejtat e kërkuesit ndaj pronës (shih paragrafin 76 më sipër), dëmshpërblimi për dëmin monetar të vuajtur nga kërkuesi duhet të kufizohet në kompensimin e duhur (shih *Statileo kundër Kroacisë* nr. 12027/10, § 156, 10 korrik 2014, dhe *Bittó dhe të Tjerët kundër Sllovakisë* (dëmshpërblim i drejtë) nr. 30255/09, § 22, 7 korrik 2015).

91. Gjatë vlerësimit të dëmit monetar të mbuluar nga kërkuesi, Gjykata nuk mund të pranojë shumat që ka paraqitur ai. Gjykata përsërit se kërkuesi nuk u zhvesh kurrë nga të drejtat e tij ndaj pronës (shih paragrafin 72 më sipër). Përpjekja e tij për të vlerësuar humbjen e përfitimit nga qiraja, në vlerën 2,160 euro në muaj (shih paragrafin 63 më sipër) është spekulative. Së fundmi, në mungesë të ndonjë parashtrimi specifik dhe dokumenti mbështetës, pretendimi i kërkuesit për shpenzime për sa u përket riparimeve dhe dëmtimeve nuk mund të pranohet. Nuk i takon Gjykatës t'i vendosë vlerën këtij pretendimi.

92. Gjykata e vlerëson të nevojshme që të kompensojë kërkuesin për dëmin monetar për pjesën e tij të pronës, duke risjellë në vëmendje se ai është një nga bashkëpronarët. Gjykata e konsideron të arsyeshme që t'i japë kërkuesit 30,000 euro për dëmin monetar.

93. Gjykata, duke vërejtur se kërkuesi nuk parashtroi ndonjë pretendim për dëmin jomonetar, gjykon se nuk ka rrethana përjashtuese, që do të kërkonin dhënien në një shpërblimi në atë aspekt (shih *Nagmetov kundër Rusisë* [DHM] nr. 35589/08, §§ 74-92, 30 mars 2017).

B. Kostot dhe shpenzimet

94. Kërkuesi kërkoi edhe 2,000 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra përpara gjykatave të brendshme dhe 2,000 euro për ato shpenzime të bëra përpara Gjykatës.

95. Qeveria kundërshtoi pretendimin e kërkuesit.

96. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, një kërkues ka të drejtën për t'u rimbursuar për kostot dhe shpenzimet vetëm për sa është treguar se këto faktikisht dhe domosdoshmërisht janë bërë dhe janë të arsyeshme sipas shumës (shih për shembull *Gjyli kundër Shqipërisë* nr. 32907/07, § 72, 20 shtator 2009). Në këtë pikë, rregulla 60 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës parashikon se kërkuesit mund të bashkëngjisin me pretendimet e tyre për dëmshpërblim të drejtë "çdo dokument relevant mbështetës", dhe kur kjo nuk ndodh Gjykata "mund të kundërshtojë pretendimet plotësisht ose pjesërisht".

97. Gjykata vëren se kërkuesi nuk parashtroi ndonjë dokument mbështetës për pretendimet e tij për kostot dhe shpenzimet. Në këtë rast, Gjykata kundërshton pretendimin e tij.

C. Interes i papaguar

98. Gjykata vlerëson me vend që norma e interesit të papaguar duhet të mbështetet në normën margjinale të huas së Bankës Qendrore Evropiane, shumë së cilës i shtohen 3 për qind pikë.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NË MËNYRË UNANIME:

1. E deklaron kërkesën të pranueshme.

2. Vendos se është shkelur neni 1, i protokollit nr. 1, të Konventës.

3. Vendos:

i. Se Shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuesit, brenda tre muajve nga data në të cilin vendimi bëhet i formës së prerë, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, 30,000 euro (tridhjetë mijë euro) plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme, për dëmin monetar, i cili do të mbulohet në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e zgjidhjes.

a) Se nga përfundimi i tre muajve të përmendur më sipër deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm për shumat më sipër në një normë të barabartë me normën margjinale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së vonesës, plus tre pikë përqindjeje.

4. Pushon pjesën tjetër të pretendimit të kërkuesit për kompensim të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 23 qershor 2020, sipas rregullës 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullave të Gjykatës.

Stanley Naismith
Sekretar

Robert Spano
Kryetar

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI DY

VENDIM
Nr. i kërkesës 40554/04

ROBERT VEVECKA KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni dy), më datë 26 maj 2020, mblodhi Dhomën e përbërë nga:

Jon Fridrik Kjølbro, kryetar,
Marko Bošnjak,
Valeriu Griţco,
Egidijus Kūris,
Ivana Jelić,
Darian Pavli,
Peeter Roosma, gjyqtarë,

dhe Stanely Naismith, sekretare e Seksionit,

duke pasur parasysh kërkesën e mësipërme të depozituar më 9 nëntor 2004;

duke pasur parasysh vërejtjet e paraqitura nga Qeveria e paditur dhe vërejtjet në përgjigje të paraqitura nga kërkuesi;

pas diskutimeve, vendosi si vijon:

FAKTET

A. Historiku i çështjes

1. Në vitet '90 dhe 2000, për shkak të migrimit të madh të brendshëm të popullsisë, u ndërtuan në vend një numër i madh ndërtesash të paautorizuara, duke krijuar vendbanime informale. Nuk ishte e pazakontë që banorët e blloqeve ekzistuese të ndërtesave ngritën shtesa ose zgjerime të paautorizuara në ndërtesa, për qëllime banimi, bënë ndryshime strukturore në banesa ose kryen çfarëdo lloj punimi pa marrë lejen e kërkuar.

2. Për shkak të përballjes me numrin e lartë të vendbanimeve të tilla informale, si dhe të shtesave e zgjerimeve të paautorizuara në ndërtesat ekzistuese, dy akte legalizimi u miratuan në vitin 2004, me qëllim rregullimin e ndërtimeve të paautorizuara (shih paragrafët 32 dhe 33 më poshtë).

B. Rrethanat e çështjes

3. Kërkuesi, z. Robert Vevecka, është një shtetas shqiptar dhe austriak, i cili ka lindur në vitin 1950 dhe jeton në Vjenë. Pas komunikimit të kërkesës te Qeveria e paditur, kërkuesi informoi Gjykatën se ai kishte fituar shtetësinë austriake.

4. Më 5 dhjetor 1996, kërkuesi bleu një apartament me një dhomë gjumi në katin e katërt të një pallati pesëkatësh në Tiranë.

5. Duket se, ndërkohë që kërkuesi jetonte në Vjenë, në një datë të paspecifikuar banorët e pallatit të kërkuesit filluan të ndërtonin një shtesë anësore, e cila bashkohej me murin verior të ndërtesës.

6. Në janar 1999, gjatë një vizite në Tiranë, kërkuesi vuri re se po kryhej ndërtimi i shtesës dhe raportoi ndërhyrjen në pronën e tij te Policia e Ndërtimit *(Policia ndërtimore)*.

7. Më 20 janar 1999, Policia e ndërtimit, duke vërejtur ekzistencën e një ndërtimi të dyshuar të paligjshëm, urdhëroi pezullimin e punimeve të ndërtimit në pritje të shqyrtimit të kundërvajtjes administrative (shih paragrafin 31 më poshtë). Procesverbali përcaktonte se "në momentin e ushtrimit të kontrollit, objekti i kundërligjshëm është në fazën e muraturës së katit IV dhe vendosjes së armaturës së kolonës së ndërtimit".

8. Më 27 janar 1999, kërkuesi, duke qenë se punimet e ndërtimit kishin vazhduar me gjithë urdhrin e pezullimit, depozitoi një padi civile në Gjykatën e Rrethit Tiranë (Gjykata e Rrethit) kundër kompanisë së ndërtimit dhe K.G., i cili ishte pronari i pretenduar i apartamentit të katit të katërt të shtesës. Në padinë e tij civile, kërkuesi kryesisht u mbështet në nenet 302 dhe 303 të Kodit Civil (KC) (shih paragrafët 22 dhe 23 më poshtë) dhe kërkoi: i. ndërprerjen e ndërhyrjes në të drejtat e tij të pronësisë; ii. pezullimin e punimeve të paautorizuara të ndërtimit; iii. prishjen e shtesës së paautorizuar; dhe iv. që ai të njihet si pronari i ligjshëm i apartamentit në katin e katërt të shtesës që mbështetej në apartamentin e tij. Kërkuesi pretendonte se shtesa kishte shkelur të drejtat e tij të pronësisë, pasi ajo kishte zvogëluar vlerën e apartamentit të tij duke penguar dritën, pamjen dhe ajrosjen dhe duke zënë pjesën e tij të parcelës që ndodhej nën ndërtesën kryesore. Gjithashtu u kishte mundësuar hajdutëve të hynin në apartament.

9. Më 18 shkurt 2000, Gjykata e Rrethit urdhëroi një raport eksperti për të marrë informacion, ndër të tjera, mbi ligjshmërinë e shtesës, gjendjen e punimeve të ndërtimit dhe çdo dëm të shkaktuar në apartamentin e kërkuesit.

10. Më datë 9 mars 2000, siç u plotësua më datë 30 mars 2000, raporti i ekspertit përcaktonte se ishin ngritur dy zgjerime të paautorizuara, njëri bashkohej me anën veriore dhe tjetri bashkohej me anën lindore të ndërtesës që përfshinte apartamentin e kërkuesit. Në lidhje me shtesën anësore në konflikt, raporti përcaktonte se ajo ishte ndërtuar nga banorët e pallatit në të cilin ndodhej apartamenti i kërkuesit, pa marrë asnjë leje paraprake. Shtesa anësore kishte hyrje dhe shkallë më vete dhe nuk kishte hapje strukturore me asnjë nga apartamentet që ndodheshin në pallatin e kërkuesit.

Raporti më tej pohonte se kishte pasur ndërhyrje në shfrytëzimin e murit verior të apartamentit të kërkuesit, i cili ishte një mur mbajtës kallkan dhe shërbente si mur veshës për apartamentin që supozohej t'i përkiste K.G. dhe në shfrytëzimin e ngastrës së tokës që shtrihej nën banesë. Punimet e ndërtimit, të cilat konsistonin në mure të suvatuara dhe në vendosjen e dyshemesë, dritareve dhe dyerve, kishin përfunduar në apartamentin e katit të katërt me dy dhoma gjumi. Asnjë dëm nuk ishte vërejtur në murin verior të banesës së kërkuesit si rezultat i punimeve të ndërtimit.

11. Më 12 maj 2000, Gjykata e Qarkut, duke vërejtur se kërkuesi jetonte në Austri që prej vitit 1994, bëri gjetje në favor të tij. Duke pasur parasysh dëshirën e kërkuesit për të tërhequr dy padi: atë kundër kompanisë së ndërtimit dhe pretendimin për t'u njohur si pronar i ligjshëm i apartamentit me dy dhoma gjumi në katin e katërt të shtesës, gjykata vendosi të ndërpresë ato pjesë të procedimeve. Duke u mbështetur në raportin e ekspertit, gjykata gjeti se K.G., i cili kishte pranuar ndërtimin e paautorizuar të shtesës, kishte blerë apartamentin me dy dhoma gjumi në keqbesim nga pronarët e paligjshëm, të cilët kurrë nuk kishin pasur një titull pronësie mbi të dhe nuk kishin qenë kurrë banorë të pallatit të kërkuesit. Më tej, ajo vendosi se shtesa ishte ngritur në mungesë të lejes së vlefshme dhe dokumentacionit tjetër teknik. Gjykata, më në fund urdhëroi K.G. që të prishte apartamentin me dy dhoma në katin e katërt të shtesës së paautorizuar, e cila kishte shkelur të drejtat e pronësisë së kërkuesit, duke shfrytëzuar murin verior të apartamentit të tij.

12. Më 19 dhjetor 2000, pas apelimit të K.G. kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit, Gjykata e Apelit Tiranë (Gjykata e Apelit) e prishi atë dhe ia ktheu çështjen Gjykatës së Rrethit për një shqyrtim të ri nga një panel tjetër. Ajo vendosi që Gjykata e Rrethit nuk kishte vlerësuar aspekte të ndryshme të çështjes, të tilla si data në të cilën kishin filluar punimet e ndërtimit, veçanërisht nëse punimet e ndërtimit kishin filluar para ose pas marrjes së pronësisë nga kërkuesi, dhe nëse ish-pronarët e apartamentit të kërkuesit kishin dhënë pëlqimin për ndërtimin e shtesës. Me urdhërimin e K.G. për të prishur apartamentin e katit të katërt të shtesës, Gjykata e Rrethit, gjithashtu, nuk kishte arritur të jepte arsye në lidhje me pasojat që një prishje e tillë do të kishte për pronarët e pretenduar të apartamentit që do të ndërtohej në katin e pestë të shtesës. K.G. nuk mund të mbahej si përgjegjësi i vetëm për ndërtimin e paautorizuar të shtesës pesëkatëshe. Edhe pse raporti i ekspertit kishte deklaruar që apartamenti i kërkuesit nuk ishte dëmtuar si rezultat i punimeve të ndërtimit, ai nuk kishte demonstruar qartë ekzistencën e ndërhyrjes në të drejtat e pronësisë së kërkuesit.

13. Pas apelimit të kasacionit të kërkuesit kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, më 7 nëntor 2001,

Gjykata e Lartë e refuzoi atë *de plano*, duke gjetur se arsyet e tij ishin jashtë objektit të arsyeve të kufizuara të apelit brenda kuptimit të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) (shih paragrafët 28 dhe 29 më poshtë).

Procedurat e rishqyrtimit (seancave të reja dëgjimore)

14. Pas rikthimit të çështjes, Gjykata e Rrethit urdhëroi një raport të ri eksperti, i cili u krye më 15 shtator 2002. Raporti i ekspertit përcaktoi se një shtesë anësore gjysmë e shkëputur, pesëkatëshe ishte ngritur dhe përfunduar në vitin 2002, bashkuar me murin mbajtës kallkan në anë veriore të ndërtesës së kërkuesit. Secili kat i shtesës kishte një apartament me dy dhoma gjumi, të cilat ishin të gjitha të zëna. Raporti nuk mund të përcaktonte natyrën e saktë të punimeve të ndërtimit të kryera nga kompania e ndërtimit, e cila kishte hedhur themelet. Ai vuri në dukje, megjithatë, se në mars 1995, kompania e ndërtimit u kishte dhënë mandate arkëtimi banorëve të ndërtesës së kërkuesit dhe se, në bazë të një kontrate (shitjeje) të datës 4 shtator 1996, S.S. i kishte shitur apartamentin e katit të katërt të shtesës D.D., i cili më pas ia kishte shitur atë K.G. Raporti nuk cilësoi ndonjë dëmtim të jashtëm, siç është lagështia, në muret e apartamentit të kërkuesit ose pengimi i dritës; ai vuri në dukje se suvaja kishte rënë nga muret e ballkonit të kërkuesit. Eksperti nuk kishte inspektuar ambientin e brendshëm të apartamentit të kërkuesit, i cili ishte i mbyllur me çelës.

15. Më 10 nëntor 2002, Gjykata e Rrethit rrëzoi padinë e kërkuesit. Duke bërë një vlerësim të provave në dosjen e çështjes, gjykata gjeti se kryerja e punimeve të ndërtimit kishte qenë pa leje, siç provohet nga urdhri i pezullimit i Policisë së Ndërtimit. Duke iu referuar faturave të kompanisë së ndërtimit, ajo zbuloi se punimet e ndërtimit kishin filluar para marsit 1995 dhe karabinaja e shtesës ishte ngritur në shtator 1996, kohë e cila ishte para blerjes së apartamentit nga kërkuesi më 2 dhjetor 1996. Sipas pikëpamjes së gjykatës, kërkuesi u ndalua të kërkonte pezullimin e punimeve të ndërtimit dhe prishjen e shtesës përderisa ato pretendime u depozituan më 27 janar 1999, e cila ishte përtej afatit ligjor njëvjeçar të parashikuar në nenin 303 të Kodit Civil. Kërkuesi nuk e kishte vërtetuar faktin se ai kishte jetuar jashtë shtetit që nga koha kur u bë pronar i apartamentit deri në vitin 1999, kur ai ngriti padinë e tij civile. As nuk kishte bërë një kërkesë për të ngritur padinë civile jashtë afatit. Gjykata e Rrethit, gjithashtu, vendosi që, në kohën që kërkuesi kishte paraqitur padinë civile në vitin 1999, pjesa më e madhe e punimeve të ndërtesës kishin përfunduar, dhe K.G. kishte zënë apartamentin e katit të katërt të shtesës.

16. Gjykata e Rrethit konsideroi se kërkesa e kërkuesit për ndërprerjen e ndërhyrjes në të drejtat e tij të pronësisë, sipas nenit 302 të Kodit Civil ishte e pabazuar. Për arritjen e këtij konkluzioni, gjykata iu referua raportit të ekspertit (shih paragrafin 14 më lart), i cili kishte gjetur se shtesa anësore bashkohej me murin mbajtës kallkan të ndërtesës së kërkuesit dhe se ajo nuk kishte penguar ndriçimin dhe ajrosjen ose hyrjen në apartamentin e kërkuesit. Gjithashtu, raporti i ekspertit kishte cilësuar se asnjë shenjë lagështie nuk ishte e dukshme në murin veshës dhe se asnjë dëm nuk mund të ndodhte në apartamentin e kërkuesit si rezultat i ndërtimit të shtesës. Në fund, Gjykata e Rrethit hodhi poshtë pretendimin e kërkuesit për t'u njohur si pronar i apartamentit në katin e katërt të shtesës si pa prova dhe pa bazë ligjore.

17. Kërkuesi apeloi, duke argumentuar se Gjykata e Rrethit kishte legjitimuar një ndërtim të paligjshëm, i cili ishte ngritur në mungesë të lejes së ligjshme dhe në shkelje të rregulloreve të planifikimit urban. Ai pohoi se Gjykata e Qarkut kishte bërë një vlerësim të gabuar të provave. Për shembull, ai kishte qenë qiramarrës para se të bëhej pronar i apartamentit në vitin 1996 dhe shtesa kishte ndërhyrë në të drejtën e tij për mbrojtjen e pronës. Kryerja e punimeve të ndërtimit kishte filluar në vitin 1999, siç u provua nga urdhri i pezullimit i Policisë së Ndërtimit dhe ai ishte brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 303 i Kodit Civil për të ngritur padinë civile. Sidoqoftë, gjykata e kishte injoruar urdhrin e pezullimit, i cili përcaktonte se muratura për katin e katërt po vazhdonte. Në parashtresat e tij të mëtejshme, kërkuesi, pa dhënë hollësira të mëtejshme, deklaroi se Gjykata e Apelit duhej t'i ishte referuar vendimit nr. 901 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të datës 14 korrik 2000 (shih paragrafin 27 më poshtë).

18. Më 15 maj 2003, Gjykata e Apelit miratoi gjetjet e Gjykatës së Rrethit, la në fuqi vendimin e saj dhe rrëzoi ankesën e kërkuesit. Gjykata, pasi vlerësoi provat në dosjen e çështjes, rikonfirmoi, se: kërkuesi kishte përvetësuar apartamentin e tij më 5 dhjetor 1996, punimet e ndërtimit për shtesën kishin filluar para 15 marsit 1995, punimet e

ndërtimit kishin përfunduar dhe apartamentet e shtesës ishin të gjitha të zëna. Ajo hodhi poshtë pretendimin e kërkuesit sipas nenit 302 të Kodit Civil si të pabazuar, pasi kërkuesi nuk kishte arritur të demonstronte se shtesa cenonte të drejtat e tij të pronësisë. Raporti i ekspertit kishte cilësuar se banesa e kërkuesit nuk kishte pësuar ndonjë dëm ose nuk ishte prekur në ndonjë mënyrë si rezultat i ndërtimit të shtesës. Gjykata më tej hodhi poshtë pretendimin e kërkuesit, sipas nenit 303 të Kodit Civil, si të paraqitur përtej afatit prej një viti të parashikuar nga ajo dispozitë.

19. Më 18 qershor 2004, pas apelit të kasacionit të kërkuesit, i cili përmbante të njëjtat arsye që ai kishte ngritur para gjykatave më të ulëta, Gjykata e Lartë hodhi poshtë ankesën *de plano*, duke gjetur se arsyet e saj ishin jashtë objektit të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile.

20. Më 18 shkurt 2005, pas ankesës kushtetuese të kërkuesit, Gjykata Kushtetuese, me një panel prej tre gjyqtarësh, e deklaroi të papranueshme *de plano* ankesën e kërkuesit, duke përcaktuar se ankesa nuk ngriti çështje në lidhje me të drejtën e kërkuesit për një seancë të drejtë dëgjimore.

C. Ligji dhe praktika përkatëse në vend

1. Kushtetuta

21. Pjesët përkatëse të Kushtetutës, në kohën materiale, përcaktojnë sa më poshtë:

Neni 42 § 2

"Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj."

Neni 131

"Gjykata Kushtetuese vendos për: ... f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave."

2. Kodi Civil (KC)

22. Neni 302 i Kodit Civil përcakton, se: "pronari [i një prone] ka të drejtë të kërkojë nga cilido që e cenon në pronësinë e tij, por pa u zhveshur nga posedimi, të pushojë cenimin, të mos përsërisë këtë në të ardhmen dhe, kur është rasti, të shpërblejë dëmet që mund t'i ketë shkaktuar".

23. Neni 303 i Kodit Civil përcakton, se: "pronari [i një prone], i cili ka arsye të shqetësohet se nga një punim i ri i filluar nga një palë e tretë në pronën e tij ose të saj ose në pronën e të tjerëve, ka të drejtë të fillojë procedurat civile me kusht që punimet të mos kenë përfunduar ose të mos ketë kaluar një vit nga fillimi i punimeve të reja". Gjykata, sipas rastit, vendos ndalimin e ndërtimit, shembjen e tij dhe urdhëron shpërblim ose rrëzon padinë civile.

24. Nenet 608 dhe 609 të Kodit Civil parashikojnë një padi nga ana e një pronari për shkeljen e një të drejte, i cili kërkon kompensim për dëmin në pronën e tij.

a) Praktika e Gjykatës së Lartë për interpretimin e nenit 303

25. Në vendimin e saj nr. 41 të datës 25 janar 2000, Gjykata e Lartë vendosi që katër kushtet e mëposhtme kumulative duhet të plotësohen për të shqyrtuar një padi civile sipas nenit 303 të Kodit Civil: i. paditësi duhet të jetë pronari ose poseduesi i një prone; ii. ekzistenca e punimeve të reja duhet të jetë e pranishme; iii. punimet e reja nuk duhet të kenë mbaruar dhe nuk duhet të ketë kaluar një vit nga fillimi i tyre; iv. ekzistenca e shkaqeve të arsyeshme se punimet e reja do të dëmtonin pronën e paditësit (shih, gjithashtu, vendimin pasues nr. 341 të datës 27 mars 2007, i cili ndjek të njëjtin arsyetim).

26. Në vendimet e saj nr. 1102, të datës 25 tetor 2001 dhe nr. 647, datë 9 prill 2003, Gjykata e Lartë hodhi poshtë ankesën e paditësve, sipas, ndër të tjera, nenit 303 të Kodit Civil, meqenëse ishte i parashkruar. Padia civile e paditësit ishte depozituar përtej afatit prej një viti (shih, gjithashtu vendimet pasuese nr. 126, të datës 14 shkurt 2006 dhe nr. 769, të datës 5 qershor 2007, që ndjekin të njëjtën qasje).

b) Praktika gjyqësore të tjera të përshtatshme të Gjykatës së Lartë

27. Vendimi nr. 901 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i datës 14 korrik 2000, siç referohet nga kërkuesi në apelin e tij (shih paragrafin 17 më lart), përcaktoi se gjykata që shqyrton një padi civile duhet të marrë një qëndrim në lidhje me të gjitha pretendimet. Vetëm paditësi mund të përcaktojë të paditurin/t dhe, si rregull, gjykata nuk mund të përcaktojë palët në procedurë.

I padituri mund të vendosë të paraqesë një prapësim ose një kundërpadi në përgjigje të padisë civile.

3. Kodi i Procedurës Civile (KPC)

28. Neni 472 i KPC-së, në kohën materiale, parashikonte, se: "Gjykata e Apelit dhe vendimet e Gjykatës së Rrethit mund të apelohen në Gjykatën e Lartë, nëse: a) ligji nuk është respektuar ose nuk është zbatuar në mënyrë korrekte; b) ka pasur shkelje serioze të rregullave procedurale; c) provat vendimtare të kërkuara nga palët gjatë gjykimit nuk janë pranuar; ç) arsyetimi i vendimit është qartësisht i palogjikshëm; ose d) janë shkelur dispozitat mbi juridiksionin dhe autoritetin."

29. Neni 480 i KPC-së, në kohën materiale, parashikonte, se: "Gjykata e Lartë do të hedhë poshtë një ankesë nëse nuk përputhet me kërkesat e parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Gjykata e Lartë vendos pa praninë e palëve për pranueshmërinë e ankesave."

4. Ligji për planifikimin urban i vitit 1998 (ligji nr. 8405, i datës 17 shtator 1998, i ndryshuar)

30. Ligji për planifikimin urban i viti 1998 përcaktoi rregullat e përgjithshme që rregullojnë planifikimin urban dhe arkitekturën e ndërtimeve në Shqipëri. Ligji krijoi një procedurë në dy nivele për marrjen e lejes së kërkuar. Fillimisht do të dorëzohej një kërkesë për leje planifikimi (kërkesa për shesh ndërtimi) për shqyrtim dhe miratim nga autoriteti kompetent bashkiak dhe ishte e nevojshme të merrej një leje ndërtimi përpara fillimit dhe kryerjes së çdo punimi ndërtimi.

5. Ligji për policinë e ndërtimi i vitit 1998 (ligji nr. 8408 i datës 25 shtator 1998)

31. Sipas ligjit për policinë e ndërtimit të vitit 1998, policia e ndërtimit ishte përgjegjëse për mbikëqyrjen e respektimit të legjislacionit për planifikimin urban, vendosjen e gjobave në rast të shkeljes së legjislacionit për planifikimin urban dhe vendosjen për pezullimin e punimeve të ndërtimit dhe urdhërimin e prishjes së ndërtimeve të paligjshme.

6. Ligjet për legalizimet të vitit 2004

32. Ligji për legalizimin e shtesave të ndërtesave (ligji nr. , i datës 23 mars 2004) hyri në fuqi në datë 25 maj 2004 dhe ligji për legalizimin e vendbanimeve të paligjshme (ligji nr. 9304, i datës 28 tetor 2004) hyri në fuqi në datë 24 dhjetor 2004 (të dyja "ligjet e legalizimit të vitit 2004").

33. Sipas ligjeve për legalizimin të vitit 2004, kërkuesit duhet të paraqisnin një kërkesë për rregullimin e ndërtesave të tyre të paautorizuara brenda afateve të përcaktuara me ligj. Pas shqyrtimit të kërkesës, autoritetet kompetente do të lëshonin një leje legalizimi kundër pagesës së një tarife, duke njohur të drejtat e pronësisë së kërkuesve mbi ndërtesën e paautorizuar dhe tokën përkatëse.

34. Të dyja ligjet e legalizimit të vitit 2004 u shfuqizuan më pas nga ligji për legalizimet i vitit 2006 (ligji nr. 9482, i datës 3 mars 2006, i ndryshuar).

ANKESAT

35. Kërkuesi u ankua sipas nenit 6 § 1 të Konventës për padrejtësi dhe zgjatje të paarsyeshme të procedurave. Ai, më tej, u ankua sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 për shkeljen e të drejtave të tij të pronësisë, për shkak të ndërtimit të paligjshëm të shtesës anësore.

LIGJI

A. Shkelja e pretenduar e nenit 6 § 1 të Konventës

36. Kërkuesi u ankua sipas nenit 6 § 1 të Konventës se procedurat ishin tepër të gjata dhe të padrejta.

37. Neni 6 § 1 i Konventës, në pjesët përkatëse të tij përcakton:

"Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ... të gjithë kanë të drejtë për një proces të drejtë ... brenda një kohe të arsyeshme ... nga [një] ... gjykatë ..."

1. Për sa i përket ankesës në lidhje me kohëzgjatjen e pretenduar të procedurave

38. Kërkuesi u ankua për kohëzgjatjen e procedurave në vend, sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

39. Gjykata përsërit se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet në kuadrin e rrethanave të çështjes dhe duke iu referuar kritereve të mëposhtme: kompleksitetit të çështjes, qëndrimit të kërkuesit dhe autoriteteve përkatëse dhe çfarë ishte në rrezik për kërkuesin në konflikt (shih, ndër të tjera *Gazsó k. Hungarisë* nr. 48322/12, § 15, 16 korrik 2015).

40. Duke pasur parasysh kriteret e mësipërme, Gjykata vëren se ka pasur një grup procedurash, të cilat filluan më 27 janar 1999 dhe përfunduan më 18 shkurt 2005. Procedurat zgjatën gjashtë vjet në

katër shkallë, tre prej të cilave e shqyrtuan çështjen dy herë.

41. Gjykata vlerëson se autoritetet vendëse kanë vepruar me shpejtësi nga 27 janari 1999 deri më 7 nëntor 2001. Ndërsa kthimi i çështjes për rishqyrtim, domosdoshmërisht i zgjati procedurat, zhvillimi i tyre i përgjithshëm nga 7 nëntori 2001 deri më 18 shkurt 2005, në katër shkallë, nuk zbulon ndonjë vonesë ose periudhë pasiviteti që do të shkelte nenin 6 § 1 të Konventës. Gjithashtu, Gjykata konsideron se kohëzgjatja e përgjithshme e procedurave nuk ka shkelur kërkesën për arsyeshmëri të kësaj dispozite.

42. Gjykata arrin në përfundimin se ankesa e kërkuesit në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë, në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

2. Për sa i përket ankesës në lidhje me padrejtësinë e pretenduar të procedurave

43. Kërkuesi u ankua në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës se procedurat civile kishin qenë të padrejta, në atë që gjykatat vendëse kishin hedhur poshtë padrejtësisht padinë e tij, si rezultat i së cilës ata nuk kishin arritur të shqyrtonin argumentet e tij në mënyrë të plotë. Ai, gjithashtu, u ankua se vendimet e gjykatave më të larta nuk ishin të arsyetuara siç duhet.

44. Qeveria parashtroi se vendimet në vend ishin arsyetuar në mënyrën e duhur, se kërkuesi kishte përfituar nga procedurat konfliktuale, të cilat, në tërësi, kishin qenë të drejta.

45. Gjykata përsërit se nuk është funksioni i saj të merret me gabimet e pretenduara të ligjit ose fakteve të kryera nga gjykatat kombëtare, përveçse nëse dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Konventa (shih, për shembull, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [GC] nr. 30544/96, § 28, GJEDNJ 1999-1, dhe *Perez kundër Francës* [GC] nr. 47287/99, § 82, GJEDNJ 2004-1), për shembull, atje ku mund të thuhet se arrin në "padrejtësi" në shkelje të nenit 6 të Konventës. Ndërsa neni 6 garanton të drejtën për një proces të drejtë, ai nuk përcakton asnjë rregull mbi pranueshmërinë e provave ose mënyrën se si duhet të vlerësohen provat, këto janë kryesisht çështje për rregullim nga ligji kombëtar dhe gjykatat kombëtare. Në parim, çështje të tilla, si: pesha e dhënë nga gjykatat kombëtare për çështje të veçanta të provave ose për gjetjet ose vlerësimet që ju janë paraqitur atyre për shqyrtim nuk janë për t'u shqyrtuar nga Gjykata. Gjykata nuk duhet të veprojë si një organ i shkallës së katërt dhe për këtë arsye nuk do të vërë në pikëpyetje sipas nenit 6 § 1 vlerësimin e gjykatave kombëtare, përveçse nëse gjetjet e tyre mund të konsiderohen arbitrare ose dukshëm të paarsyeshme (shih, për shembull, *De Tommaso kundër Italisë* [GC] nr. 43395/09, § 170, 23 shkurt 2017, dhe referencat e cituara në të).

46. Efekti i nenit 6 § 1 është që t'i vendosë gjykatat vendëse në detyrë që të kryejnë një shqyrtim të duhur të parashtresave, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët, pa cenuar vlerësimin e tij, nëse ato janë relevante për vendimin e saj (shih *Carmel Saliba kundër Maltës* nr. 24221/13, § 64, 29 nëntor 2016). Detyra e vetme e Gjykatës në lidhje me nenin 6 të Konventës është të shqyrtojë kërkesat që pretendojnë se gjykatat vendëse nuk kanë respektuar masa specifike mbrojtëse procedurale të parashikuara në atë nen ose që zhvillimi i procedurave në tërësi nuk i garantoi kërkuesit një proces të drejtë (shih, për shembull, *Centro Europa 7 Srl dhe Di Stefano kundër Italisë* [GC] nr. 38433/09, § 197, GJEDNJ 2012, dhe *Donadze kundër Gjeorgjisë* nr. 74644/01, §§ 30–31, 7 mars 2006).

47. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata vëren se kërkuesi, duke u mbështetur në nenet 302 dhe 303 të Kodit Civil, filloi procedurat për ndërhyrje në të drejtat e tij të pronësisë, për shkak të ndërtimit të paautorizuar të shtesës anësore.

48. Gjykata vëren se kërkuesi vazhdimisht ankohej për ndërtimin e paautorizuar të shtesës anësore, e cila ishte në qendër të kërkesës së tij sipas nenit 302 të Kodit Civil. Si përgjigje, Gjykata e Rrethit, në procedurat e rishqyrtimit, u dha një peshë të konsiderueshme argumenteve të kërkuesit dhe pranoi paligjshmërinë e ndërtimit të shtesës anësore. Sidoqoftë, duke urdhëruar një raport të ri eksperti, i cili arriti në përfundimin se apartamenti i kërkuesit nuk kishte pësuar ndonjë dëm të jashtëm, përfshirë lagështirën dhe se shtesa nuk kishte penguar ndriçimin dhe ajrosjen ose hyrjen në apartamentin e kërkuesit, Gjykata e Rrethit, në procedurat e rishqyrtimit, hodhi poshtë pretendimin e tij (shih paragrafin 16 më lart). Në veçanti, Gjykata e Rrethit gjeti se neni 302 i Kodit Civil, i cili rregullon ndërhyrjen e vazhdueshme në gëzimin e pasurisë së dikujt, nuk ishte i zbatueshëm për rrethanat e çështjes së kërkuesit. Gjykata

konstaton se Gjykata e Qarkut dha arsye, të cilat nuk mund të konsiderohen qartazi të paarsyeshme ose arbitrare.

49. Gjykata më tej vëren se kërkuesi mund të përfitonte nga mundësia për të apeluar kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit (shih paragrafin 17 më lart). Ai nuk u ankua se nuk kishte përfitimin e procedurave konfliktuale. Në fazat e ndryshme të këtyre procedurave, qoftë personalisht ose përmes avokatit të tij, kërkuesi mund të paraqiste argumentet që i konsideronte të përshtatshme për çështjen e tij. Në apel, Gjykata e Apelit, duke iu referuar gjetjeve të raporteve të ekspertit, la në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët, duke shpjeguar se kërkuesi nuk kishte vërtetuar se kishte pasur një ndërhyrje në gëzimin paqësor të apartamentit të tij (shih paragrafin 18 më lart). Prandaj, Gjykata nuk konsideron që, për sa i përket pretendimit të kërkuesit, sipas nenit 302 të Kodit Civil, gjetjet e gjykatave vendëse ishin arbitrare ose haptazi të paarsyeshme.

50. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit sipas nenit 303 të Kodit Civil, gjykatat vendëse gjetën se punimet e ndërtimit kishin filluar në një datë të paspecifikuar para marsit 1995 dhe kërkuesi e bleu apartamentin e tij në 5 dhjetor 1996 (shih paragrafët 15 dhe 18 më lart), datë në të cilën ai së paku duhet të ketë qenë në dijeni të ndërtimit. Nuk ka asgjë në dosjen e çështjes që të tregojë se kërkuesi nuk mund të parashikonte rrjedhën e punimeve të ndërtimit. As nuk mund të konkludohet se ai ishte penguar të vizitonte apartamentin dhe vendin e ndërtimit, si rezultat i së cilës ai nuk mund të kishte vërejtur punimet e ndërtimit.

51. Megjithatë, kërkuesi depozitoi padinë e tij civile në Gjykatën e Rrethit, më 27 janar 1999, përtej afatit ligjor prej një viti të parashikuar në nenin 303 të Kodit Civil. Gjykata , se, pavarësisht nga data e zhvendosjes së aplikantit në Austri ose data e blerjes së apartamentit, gjykatat vendëse nuk duket se gabuan në llogaritjen e tyre të afatit prej një viti. Për më tepër, vlerësimi i provave nga gjykatat e vendit dhe interpretimi i ligjit vendës nuk ishte në mospërputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë për këtë çështje (shih paragrafët 25 dhe 26 më lart). Si pasojë, vendimi i gjykatave vendëse që përcakton pretendimin e kërkuesit sipas nenit 303 të Kodit Civil, si të parashkruar nuk ishte as arbitrar dhe as haptazi i paarsyeshëm.

52. Në fund, Gjykata vëren se ankesa e kasacionit të kërkuesit në Gjykatën e Lartë ishte në thelb e njëjtë me apelin e tij në Gjykatën e Apelit, e cila e kishte shqyrtuar dhe adresuar atë. Gjykata vlerëson se arsyet e kufizuara të dhëna nga Gjykata e Lartë në formulën e saj të papranueshmërisë tregojnë në mënyrë të nënkuptuar që kërkuesi nuk kishte ngritur një nga pikat e ligjit të parashikuar nga neni 472 i KPC-së. Gjykata vëren se kur një Gjykatë e Lartë refuzon të pranojë një çështje në bazë të asaj që nuk ka ngritur baza ligjore për apel, arsyetimi shumë i kufizuar mund të përmbushë kërkesat e nenit 6 të Konventës (shih *Marini kundër Shqipërisë* nr. 3738/02, § 106, GJEDNJ 2007 (ekstrakte)). Ishte për të njëjtat arsye që Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë ankesën kushtetuese të kërkuesit në lidhje me shkeljen e së drejtës për proces të drejtë.

53. Në kuadrin e konsideratave të mësipërme, Gjykata konsideron se ankesa e kërkuesit se procedurat ishin të padrejta është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

B. Shkelja e pretenduar e nenit 1, të protokollit nr. 1 të Konventës

54. Sipas nenit 1, të protokollit nr. 1 të Konventës, kërkuesi u ankua se të drejtat e tij të pronësisë ishin shkelur si rezultat i ndërtimit të një ndërtese të paligjshme.

55. Neni 1, i protokollit nr. 1, të Konventës thotë:

"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera."

56. Kërkuesi parashtroi se shtesa e ndërtuar në mënyrë të paligjshme ngjitur me apartamentin e tij kishte penguar ndjeshëm ndriçimin dhe ajrosjen e saj. Ai nuk kishte mundur as ta shiste apo ta jepte me qira apartamentin.

57. Qeveria argumentoi se gjykatat vendëse kishin vendosur se shtesa nuk cenonte posedimin paqësor të pronës së tij nga kërkuesi. Ato u

mbështetën në një raport tjetër eksperti që kishin porositur, i cili përcaktonte se shtesa nuk ndërhynte në ndriçim dhe ajrosje ose për hyrjen në apartamentin e kërkuesit. Ato më tej deklaruan se shtesa ishte ndërtuar në një ngastër toke publike, e cila i përkiste Shtetit, pas pëlqimit kolektiv të të gjithë banorëve të tjerë. Si i tillë, legalizimi i shtesës ishte një çështje që duhej zgjidhur midis shtetit dhe banorëve të saj.

58. Qeveria pretendoi se paaftësia e kërkuesit për të shitur ose dhënë me qira banesën ishte për shkak se ai nuk e kishte mirëmbajtur atë ose ngaqë nuk kishte vendosur dritare dhe xhama.

59. Gjykata vëren se asnjë nga palët nuk e kontestuan zbatueshmërinë e nenit 1, të protokollit nr. 1. Ajo nuk sheh asnjë arsye për të vendosur ndryshe.

60. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se neni 1 i protokollit nr. 1 përcakton, gjithashtu, disa detyrime pozitive. Në rastet që përfshijnë çështje gjyqësore midis palëve private, Shteti ka një detyrim pozitiv që t'u lejojë palëve në mosmarrëveshje procedurat gjyqësore të cilat ofrojnë garancitë e nevojshme procedurale dhe për këtë arsye u mundëson gjykatat vendore që të gjykojnë në mënyrë efikase dhe të drejtë çdo mosmarrëveshje midis palëve private (shih, për shembull, *Kotov kundër Rusisë* [GC] nr. 54522/00, § 114, 3 prill 2012; *Blumberga kundër Letonisë* nr. 70930/01, § 67, 14 tetor 2008; dhe *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës* nr. 48553/99, § 96, GJEDNJ 2002-VII).

61. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata vëren se kërkuesi ankohet kryesisht për mënyrën se si gjykatat vendëse interpretojnë dhe zbatojnë ligjin vendës në procedurat, para së gjithash, midis palëve private.

62. Siç ka gjetur Gjykata në shqyrtimin e ankesës së kërkuesit në lidhje me padrejtësinë e pretenduar të procedurave në vend sipas nenit 6 § 1 të Konventës më lart, gjykatat vendëse bënë një shqyrtim të përgjithshëm faktik dhe ligjor të interesave të ndryshëm në fjalë dhe hodhën poshtë pretendimet e kërkuesit duke dhënë arsye që nuk mund të konsiderohen haptazi të paarsyeshme ose arbitrare. Vlen të përmendet se gjykatat vendëse pranuan ndërtimin e paligjshëm të shtesës. Për më tepër, ata zbuluan se shtesa nuk kishte penguar ndriçimin dhe ajrosjen ose hyrjen në apartamentin e kërkuesit, i cili nuk kishte pësuar ndonjë dëm të jashtëm si rezultat i ndërtimit të paligjshëm.

63. Gjykata nuk mund të gjejë ndonjë bazë mbi të cilën të konkludojë se gjetjet e gjykatave vendëse ishin prekur nga ndonjë element ose arbitraritet ose se ato përndryshe ishin qartazi të paarsyeshme.

64. Për sa i përket mbrojtjes procedurale të interesave të kërkuesit, Gjykata vëren se kërkuesit, i cili ishte përfaqësuar siç duhet gjatë procedurave në vend, iu dha mundësia e mjaftueshme për të çuar përpara të gjitha argumentet që ai i konsideronte si të rëndësishme për rezultatin e çështjes dhe përfitoi nga procedurat konfliktuale.

65. Nga kjo rrjedh se ankesa e kërkuesit, sipas nenit 1, të protokollit nr. 1, të Konventës, është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë, në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime:

E deklaron kërkesën të papranueshme.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 25 qershor 2020.

Stanley Naismith
Registrar
Sekretare

Jon Fridrik Kjølbro
Kryetar

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 418 (1480), datë 27.7.2020, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Gjenci Mitri Lena, i datëlindjes 15.1.1961, dhe caktimin si kujdestar të tij shtetasin Stavri Mitri Lena.

KËRKESË

Shtetasja Adelina Allko kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të vdekur të shtetasit Arben Allko, i lindur më 12.5.1966, dhe vdekur më 25.12.1997.

KËRKUESE
Adelina Allko

KËRKESË

Shtetasja Rihane Lila kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, shpalljen si të zhdukur të shtetasit Lulëzim Hasan Lila, i datëlindjes 8.11.1968, si dhe caktimin e saj si kujdestare të pasurisë së tij.

KËRKUESE
Rihane Lila

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2020 - Numri: 180
Datë: 2020/10/13 13:34:53
6c06997c-46cf-4584-b1ea-3aea2049b582

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 392 lekë